





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2023 merr këtë:

## **V E N D I M**

### **për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.01.2023**

#### **Neni 1**

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për procesverbalin nga mbledhja e parë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 30.01.2023

#### **Neni 2**

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 30.01.2023.

#### **Neni 3**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË PARË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.01.2023 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnor Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emiri, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu, z.Sokol Hyseni, z.Ilir Zuka, ndërsa mungoi znj.Taibe Ibrahim, z.Sokol Shaqiri, z.Reshat Azizi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, gjatë tërë vitit të kaluar me vendimet e tona që kemi marr në kuvend të gjitha deri tash janë të rregulluara me ligjshmëri përpos strategjisë zhvillimore lokale për të cilën është kërku plotësim me disa informata shtesë. Po e presim konfirmimin përfundimtar a është i plotë edhe planin për energji dhe klimë, domethanë edhe këta kanë kërku dokumente shtesë. Jemi duke e pritë vendimin përfundimtar, a është konfrom ligjit. Duke e pas parasysh që në këtë seancë është edhe informata vjetore e kryetarit të komunës, zakonisht kur kemi pas informatën, pikën pyetje përgjigje zakonisht e kemi bërë me këtë informatën e parë që nuk i kemi bërë dy pika, sepse të gjitha gjërat janë që lidhen me të njëjtën pikë. Mendoj që sot e kemi mirëkuptimin dhe sot shkojmë me të njëjtën pikë, sepse janë çështje të përbashkta që lidhen me këtë pikë të rendit të ditës. Për këtë seancë materialin e keni marrë me kohë, rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe kemi parapa këtë rend dite:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal.
2. Informatë (raport) për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2022.
3. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2023.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planeve të punës së komiteteve: Komitetit për Shërbime Publike; Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore; Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit; Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport; të gjitha planet për vitin 2023.

## 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ne si grup i Lëvizjes Vetëvendosje paraprakisht kemi pas domethanë kërkesë të bëjmë një seancë të jashtëzakonshme, por meqenëse sot është seanca e rregullt e kemi parë të rrugës dhe në kuadër të ligjit që na lejohet të paraqesim para jush një pikë të re të rendit të ditës, domethanë në bazë të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores së Kuvendit Komunal të Vitisë, neni 7, Lëvizja Vetëvendosje, grupi asamblistëve propozon pikë të re të rendit të ditës, falja e tatimit në pronë në vlerën deri në 100 euro për të gjithë tatimpaguesit e komunës sonë për vitin 2023, me qëllim të lehtësimit të barrës së qytetarëve, Ministria e Financave ka bërë propozim konkret për komunat që të gjithë tatim paguesve të ju falen deri në 100 euro nga vlera e tatimit në pronë. Kjo do të përfshihet në kuadër të një ligji të ri të cilin ministria do ta proceson shumë shpejt në kuvend për miratim. Në këtë ligj do të përfshihet dispozitat e faljes së faturës së tatimit deri në 100 euro në vitin 2023 si dhe do të mundësohet rritja e fleksibilitetit të komunave dhe do të arrihet tatim progresiv për vitin 2024 e tutje, ashtu që ata që kanë më pak të paguajnë më pak dhe ata që kanë më shumë të paguajnë më shumë. Me këtë propozim, domethanë që secilit tatimpagues t'u falen deri në 100 euro të faturës, tatimit në pronë, 85% e tatimpaguesve nuk do të paguajnë asgjë për vitin 2023 ata që tashmë kanë paguan domethanë ju llogariten si parapagim për vitin vijues, 10% do të paguajnë më pak se 100 euro për vitin 2023, pra vetëm këta 5% e tatimpaguesve që përfshihen edhe bizneset ju bie të paguajnë më tepër se 100 euro për vitin 2023, andaj duke pas parasysh këtë kornizë ligjore të cilën aktualishtë për tatimin në pronë dhe me qëllim të lehtësimit të barrës së qytetarëve, ne si grup i asamblistëve ftojmë të gjithë antarët e kuvendit komunal që ta mbështesin këtë pikë.

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Mbështes propozimin e kryesuesit që në këtë seancë të mos ketë pyetje përgjegje jashtë rendit të dites, pasi që kemi informatën e kryetarit edhe i kemi pasqyrat financiare do të përfshihen në kuadër të këtyre 2 pikave. Sa i përket propozim vendimit të VV-së për pikë të re me futë në rend të ditës, shumë mirë e shpjegove, vendimin e ka marrë qeveria, ministri i financave. The shumë shpejt ministri do të del me një sqarim, plotësim ndryshim ligjor që do ta anuloj këtë rritje që e ka bërë të tatimit në pronë, çka ne si kuvend komunal edhe ku është fuqia jonë që ne me ndërhy në vendimet e qeverisë, në këtë rast të ministrit të financave. Boll bre ma me këta popullizma se është tepru. Kur po e them këtë, po bazohem në atë se ai që e ka rrit ai ne ta shfuqizon. Qytetarët deri në një vendim të ri ne ta paguajnë tatimin në pronë qysh e kan pagu në vitin 2022, kqyrim më tutje, ne jemi këtu, jemi në mbështetje edhe përkrahim qytetarët, nuk është vetëm VV që është përkrah popullit edhe duke e mbrojtë popullin edhe këto gjëra populli nuk i toleron dhe nuk i pranon. Faleminderit!

**z.Taulant Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë e pashë propozimin e Majlindes, unë po e shof që këta po dojnë me bë diçka që ministri i tyre e ka bërë një gabim trashanik, këta po dojnë me kthy këtu ne e dimë që tatimi në pronë është 90% e qytetarëve të Komunës së Vitisë. Tatimi në pronë është e hyra kryesore e komunës, nëse kjo falet atëhere neve na dështojnë shumica e projekteve të planifikuara në qoftëse këta dojnë, e kanë ministrin, ta shfuqizon këtë që e ka bërë e pagumi tatimin në pronë që e kemi pagu vitet e kalume. Unë nuk po e shofë të arsyeshme kur ministri e bënë një gabim edhe qohen asambleistat folin këtu ne jemi për qytetarët, por ne nuk mundemi atë që i kemi planifiku mi realizu, në qoftë se ne e votojmë këtë që e ka propozu e nderuara asambliste.

**z.Illir Zuka:** Shumë shkurt për shkak se atë që deshta me thanë e tha Taulanti. Në mbledhjen e KPF-së kur e kam ngritë në fund, domethanë në shikim të pasqyrave financiare jam kanë unë, ai që e kam ngrit as nuk e kanë ditë këta, por me vendim prej ministrit çdo komune ju ka thënë me ngritë këtë, me i lanë këto kamofllazha, me i lanë këto sene ne të kthehen ka qytetarët, se dihet që është vendim i ministrit mos kqyrni mi qit keq tashti partitë tjera, kishe ne jemi me qytetarët, u pa kush sakt është me qytetarët, e keni rritë çdo sen, tu ja nis prej mbeturinave, ujësjellësit, tatimit në pronë, rryma, çka keni me rrit tjetër, leni më këto gjëra, ju kanë kuptu qytetarët, i keni bërë

postimet në facebook, faqja e vetëvendosjes në Viti, kqyrni sa reagime të qytetarëve keni marr, ju kan parë më qytetarët, mos u munoni me kamofllazh se janë tu ju njoftë kush jeni.

**z.Remzi Salihu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Po më duket sa po e shofë unë, këtu nuk orientohen se si të ja bëjmë, ta fusim në rend të ditës pikën e propozuar nga asamblistja e VV-së apo jo, por po shkohet në atë mënyrën tjetër të luajm pingpong. Mesa po e shofë unë, dikush ndoshta e llogaritë veten si një lojtarë superior i pingpongit, por jo nuk do ta tolerojmë pse po e themë këtë, sepse qysh ajo çfarë ju po thoni apo çfarë ju po mendoni se Vetëvendosja juve ju ka bërë si alergji, domethanë si sëmundje e pashërueshme jo edhe Vetvendosja edhe këshilltarët e Vetvendosjes domethan janë këtu nga vota e qytetarëve, për qytetarët dhe nuk dua këtu të pranoj kurrfarë demagogjie, se ministri i financave e paska ngirtë tatimin në pronë, jo ministri i financave ka bërë vlersimin e pasurisë të asaj pasurisë që dikush deri sot ka përfitu nga ajo dhe duke e ulë vlerën e pasurisë së vetë e ka pagu tatim më së paku, kurse të tjerët domethan atyre që janë pakë më të varfër ja u ka bërë vlerën ashtu si e kanë dhe kanë paguar në mënyrë të rregullt, andaj ju lutem mos u merrni më këtë, se nuk jemi ka merremi me politikë, po dinë disa njerëz pasurin atje ku e lajmrojnë, thotë shpija ime i bënë 200 mijë euro. Po si more, unë jetoj afër teje, pse e jotja 200 mijë e jemja 10 mijë. Po e jemja është ja bëjë çmimin sa dua! Nëse ja vnon çmimin sa don, atëhere paguaj edhe tatimin. Krejt në fund thërras të gjithë assembleistat që ta votojnë këtë pikë të hyjë në rend të ditës, ta diskutojmë edhe mandej të shohim se ku jemi, prandaj ne nuk jemi këtu për të luajtur pingpong, por jemi për qytetarët e Komunës së Vitisë dhe besoj dhe shpresoj që do të përfitojmë nga kjo. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Duke e pas parasysh dhe kjo temë është që 1 javë, e kam parë në media dhe jam konsultu me një pjesë të njerëzve që e dinë këtë pjesë të ligjit, dhe në asnjë vend, as Ligji për Vetëqeverisje Lokale, as Ligji mbi Financa nuk shkruan që kuvendi komunal ka të drejtë me fal tatimin në pronë. Kjo është më e keqja nëse ne e marrim një vendim dhe nuk ka të drejtë kuvendi komunal me fal tatimin në pronë, dhe ne e marrim një vendim të tillë dhe na kthehet jo i ligjshëm. Është cek shumë mirë këtu ku e lexoj edhe Majlinda në kuadër të ligjit të ri, pse ne me marrë vendim nëse bahet ligji i ri, atëhere ligji i ri në t'i zbret tarifat. Një po ju themë, nuk ka vlerë më të madhe sa me pas një shpi dhe me shku me pagu tatimin në pronë, binduni që nuk ka nënçmim më të madhë sa personi që e merr një rrogë të shtetit dhe personat që kanë çështje ose punë më të mira dhe me pagu tatimin në pronë sa e kemi, mesatarisht 20-30 euro edhe ato me shku me i falë. Unë mendoj që është keq, ne duhet me i diskutu për çështjet te ata që nuk kanë mos të i pagujnë, jo tek ata që kan miliona, jo tek ata që kanë banesa, sepse pjesën më të madhe jemi duke e përfshi këtu. Ne e kemi miratu buxhetin, ne kemi qu gishtin që tatimi në pronë lidhet, është i parapam buxheti sa është dhe atë buxhet e kemi bartë në projektet nëpër projekte të ndryshme, sepse participimi i të hyrave vetanke shkon në pjesën e projekteve. Ne tashti edhe këtë nëse e falem, nëse është kanë 90% në Komunën e Vitisë janë përmirë 95% që janë ner 100 euro dhe na tatim në pronë nuk kemi me mbledhë për këtë vit. Ne duhet me kërku që me i jek kamatat nëse nuk mundet me pagu dikush tatimin në pronë edhe i shtyhet, ne duhet me falë tatimin në pronë për dikënd që nuk mundet me pagu, ne nuk mundemi me fal tatimin në pronë për neve çka jemi këtu. Unë mendoj që e kemi gabim, por ne duhet më së pari me vërtetu ligji a na lejon, dhe binduni që ligji nuk na lejon.

**znj.Majlinda Shabani:** Faleminderit shumë! Unë në fakt kam shumë me plotësu. Fillimishtë u përmend popullizmi, i bie që ne kemi mbajtë popullizem edhe për shkollën e Pozheranit, meqenëse kompetencat kanë qenë ndaj qeverisë, është e tepër moralizimi që bëhet këtu, nëse me të vërtet e keni shqetësuese hallin edhe brengjen e qytetarëve, ju kishit qenë pro kësaj, nuk pajtohem absolut me atë që e thave kryesues, për shkak tani i bie që nëse është bërë planifikimi po i bie që kryetari i paska ditë që paska pas rritje të tatimit për pronë, kur e dimë që komuna e ka kompetencë me caktu shkallen tatimore, e ministria atje me bë vlerësimin pse kryetari nuk e ka pru si pikë të rendit të ditës me ndryshu shkallen tatimore, pse nuk është ngritë asnjëhere ky shqetësim, po a e dinë ëka bënë kryetari. Kryetari del me postime në facebook, me majt moralizëm, ky është moralizëm i tepërt.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kuvendi i cakton normat, normat janë koeficient, ndërsa vlerën e cakton ministria në bazë të ligjit. Ne e kemi koeficientin minimal 0.15% më i vogli që egziston në ligj e ka Vitia tatimin në pronë

qe sa vite, asnjëhere nuk e kemi ndyrshu, koeficienten 0.15 e kemi. Tatimin më të ulët që e kemi caktu, ndërsa vlera çka është përcaktu tashti prej ministrisë jemi e 5-ta në nivel të Kosovës, edhe qytetet e mëdha paguajn më pak se sa Vitia, çka është e vlerësuar vlera me nivel ligji që vlerësohet. Kjo është ajo brenga që duhet ta diskutojmë, ndërsa ne çka e kemi caktu si kuvend komunal koeficientin 0.15, është minimumi që nuk ka në ta, më e vogla vlerë.

**znj.Majlinda Shabani:** Domethanë pajtohem me mendimin tënd që e ke, por nuk pajtohem me qasjen që e ke. Domethanë është shumë logjike kjo kemi rritje të vlersimit që ju bëhet, por nëse ne e falim i bjen që ne nuk kemi me pas më pak për shkak se çdo e hyrë te tatimi në pronë i shkon direkt komunës, nuk i shkonë as qeverisë as ministrisë, e tregoni këtu çka ka pas interes ministria me rritë tatimin në pronë, meqenëse të hyrat i shkojnë komunës. Nëse ne e kemi me të vërtet hallin edhe brengen e qytetarëve, qasja jonë duhet me ndryshu.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë po e shofë që kjo murr kahje politike, kështu njëfar lufte, por ne e kishim kry punën tonë dhe tashti nëse shkelet ligji na e kthen ministria që nuk jemi në harmoni me ligjin, se po më vie keq kryesues, por tashti po luajmë dy kuti, se kemi pas këtu vendime që keni thanë është gabim, është shkelje, ne e qojmë edhe këtë atje e mandej e korrigjon, ne e qojmë edhe këtë atje e mandej e korrigjon ligji kur është diçka që bënë ne të bëjnë krejt. Sa i përket Ilirit që tha, këta nuk kanë qenë në dijeni. Ilir, me të thanë të drejtën kjo është bërë shumë mediatike dhe është bërë special për me luftu Lëvizjen Vetëvendosje, këtë ligj nuk e ka bërë Lëvizja Vetëvendosje, këtë rritje të tatimit nuk e ka bërë, kjo është bërë në 2018-ë, në vitin e parë nuk ka qenë me pagu hiq, ka fillu prej vitit 2019 gradualishtë nga 20% me u rritë tatimi, që ky vitë e kap 100%. Çfarë përgjegjësie kemi ne për këtë ligj, ministri vetëm se e ka zbatu ligjin, atë ligjë që e ka bërë LDK dhe e ka zbatu ai në fuqi kur ka qenë PAN-i në qeveri. E dyta, po lidhem pak te tatimi në pronë, sipas të drejtave të auditorit kombëtar të ZKA-së, këtu thotë disa komuna nuk e kanë bërë vlerësimin e drejtë për shkak se disa pronar të pronave nuk i kanë numrat personal të regjistrum dhe kanë mundur dy e më shumë prona t'i rigjistrojnë si vendbanim bazë prioritar dhe më së keqi qëndron Komuna e Vitisë, për shkak se i ka mbi 1 mijë tatimpagues në pronë që nuk i kanë të regjistruar numrin personal, e që i bie që të gjithë këta kanë mundur të regjistrojnë 2 e më shumë prona si banim rezidencial apo banim parësor. Tjetra është që, ne e kemi për qytetarin tonë mos të thojmë vetëm në nivel qëndror ne e kryem punën tonë të cilën nuk e kemi kry në tetor 3 komuna në të gjithë Kosovën kanë kthyer rekomandimet e veta të gjitha të tjerat duke përfshier edhe komunën tonë nuk kanë dhanë asnjë rekomandim për këtë dhe ministri e ka zbatu atë, nëse vazhdoni kështu kjo është e drejtë e juaja por mos thuani që e kemi për qytetarin, se qëtu veq një vendim gjeni tonin që ka qenë në interes të qytetarëve tonë që nuk e kemi votu këtu apo që e kemi diskutu, por tashtë na dul ftyra e vërtet e juaja mos ja nxerrni fundin.

**z.Ilir Zuka:** Jakup, ti po thua që po e votojmë po e qojmë po e shkelim, ti po donë me shkel vet ligjin, a po? Se qështu the, ne po e votojmë ne të na kthen ministria, çka po i bie kjo, po i bie për qytetarin apo çka po i bie. A jeni kordinu me propozuesen? Se njëra thojke e ka rritë ministri, njëra komuna. Kur ti bini kordinonu me propozuesin e asaj edhe të gjithë e dimë që kjo është përgjegjësia e qeverisë, këtë rritje e ka bërë qeveria, ministri, është vendim i qeveris rritja, po pse nuk po e pranoni, pse po doni me mbulu një faj të tyre, dilni para qytetarëve që është bërë rritja se e dimë krejtë, leni këto sene.

**z.Ramadan Deliu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë mendoj që fjala fjalën nuk e mund, dikush shet mend këtu, dikush bënë patriotizëm. E ka propozu, qite në votim, kalon, mirë, nuk kalon, kurgja kërkujtë. Faleminderit!

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Faleminderit kryesues! Të nderuar të pranishëm, të respektum kshilltarë, qeveri komunale, media, OSBE, zyrat që jeni këtu të komunës dhe të gjithë të pranishmit. Më së pari propozimi, pika që e propozoj këshilltarja është legjitime me propozu pika, por nuk është legjitime me key prej ksaj pikës te shkolla e Pozheranit me ataku kryetarin drejtpërdrejt pa i bë asgjë, shumë palidhje mu dokë, dhe vërtet i dha shije të keqe sjelljes, sinqerishtë. Kjo është veç një jostabilitet edhe karakterial jo veç institucional, vërtet është jo e jeshme edhe mu dokë shumë palidhje, edhe nuk patë pika e Pozheranit me këtë pikë qka e propozove kshilltare. Mundemi me trajtu edhe piken e Pozheranit, veç me trajtu në parim, se qëtu janë këshilltarët

e kuvendit komunal dhe qeveria komunale, të këqi e të mirë këta janë. Janë zyrat, janë njerëzit të cilët duhet me punu në përputhshmëri me ligjin, propozim vendimi që e ke propozu ti tërheq reproporcione financiare, pasi tërheq reproporcione financiare duhet me kalu nëpër instanca, nuk mundet me kalu në kuvend. Kjo pa kalu në Komitet për Politikë dhe Financa, eventualishtë kur kuvendi e voton, por unë po thamë që këtë pikë jo ligjore kuvendi nuk e voton. Plotsishtë ka pasë Jakup të drejtë këshilltari që tha, kjo është tërsisht popullsite, se qeverinë qendrore në fakt jeni tu e udhëheq ju dhe ju keni mundur që ta pyesni ministrin ose Zyrën Ligjore të ministris, a është legale kjo. Unë po them që nuk është legale, për shkak se po e vazhdoj aty ku e lash, repupocioni financiar e terhekum për shkak se planifikimi i buxhetit për vitin 2023 është bërë nga ky kuvend dhe kur është bërë miratimi i buxhetit aty në planifikim të hyrave vetanake i ki edhe tatimin që e thatë ju vetë tatimin bazë të hyrave vetanake, domethanë tatimin mbi prona, andaj për këtë vit e ke planifikimin buxhetor dhe nuk mundesh me terhek kësi reproporcione financiare, se nuk mundesh me shkel ligjin. Edhe një, normal që ta kthejnë jo ligjore, 100 % po ta garantojë atë, por ne nuk e lejojmë hiq me shku dhe me na kthy jo ligjore, për shkak se ne po mundohemi me punu me rregullaritet ligjor. Gjatë tërë vitit 2022 kemi punu me rregullaritet ligjor, edhe 2023 ka me u punu me rregullaritet ligjor. Kjo duhet me kalu nëpër organe, mirëpo kompetente është Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë, i cili vlerësimin e pronave i ka bërë, por nuk i ka llogaritë reproporcionin financiar edhe ka dalë se dëmtohen qytetarët, e buxheti i shkon qeverisë e qeveria në fakt buxhetin nuk ka ditë as me hargju, se shikoja përqindjen, për shkak se vetëm 1/3 e buxhetit të përgjithshëm shkon nëpër komuna. Unë jam anëtar i komisionit të grandeve atje, edhe në komision të grandeve duhet me u trajtu kjo temë, por nuk është trajtu, ajo është me ligj, pasi komunat e vjelin tatimin në pronë. Komisioni i grandeve ku bëjnë pjesë 4 ministra edhe 4 kryetar, edhe kryeministri që është me ligj i themelum për buxhetin e komunave, duhet me u grumbullu edhe duhet me u marr vendim edhe e ka afatin sikur Këshilli për Siguri në Bashkësi që e ka afatin statutor, ashtu e ka edhe komisioni i grandeve. Nuk ka kalu, prandaj në këtë kuptim duhet mos me bë vendime kuvendi jo legale dhe jo ligjore dhe që dëmtojnë krucialishtë buxhetin e komunës edhe vendime jo ligjore nuk mund të marrim, ndërsa bashkëbisedimi tjetër, udhëzimi administrativ, tjera, vlersimi pronës në formë tjetër, ka mujtë me asosacionin e komunave, me bordin e saj me organizu, por kjo mbetet për të ardhmen. Shfuqizimi i këtij vendimi është zgjidhje, mos me gabu qytetarëve me ja u marr parat nga gjepi i varfër që po i quani. Ju, mos i merrni atëhere pare më shumë se sa që e kanë pas, edhe kaq. E shndërrut në debat jashtë pikave që kanë qenë, ndoshta edhe ky është qëllimi, me shndërru debat kësi pika jashtë pikës.

**z.Jakup Demiri:** Ilir, atë ditë është e vërtet që kemi diskutu temën, ti e ke hapë, nuk është që nuk e kem ditë, që the as nuk e kanë pas idenë. Ne e paskem bë krejtë këtë farë problemi, a knej e kanë bërë pa vetëdije. Iliri e ka (**nuk kuptohet**), po qyteterin ku e ke, pse nuk e ke pru një dokument, pra një ide, një zgjidhje me mujtë me bë jo vetëm me bë zhurmë. Sa i përket kryetar që the, kemi punu me rregullaritet të plotë. Po uroj të jetë ashtu, por ne e dimë që mbi 50% dalin vendimet e këtij kuvendit komunal i ki të kthyme prej ministrisë, prej MAPL-së, ne këtu jemi mbi 50% të propozim vendimeve këtu na u kanë kthy, kemi pasë 2 seanca, asnjë pikë nuk kemi pas të re, i kemi pasë vetëm të kthyme të i tregoj cilat janë.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Ti me fol jashtë rendit të ditës kutrum mundesh me folë çka dush, se kjo është më fol kutrum, por nëse donë me saktësi, qe ku e ke Zyrën Ligjore. Që tri here jashtë rendit të ditës po diskuton, po të lejon kryesuesi, se ti nuk ki të drejtë. Unë vetëm një here diskutova, tu përgjigja për shkak se ma përmende emrin.

**z.Jakup Demiri:** Kryetar, tu kisha lutë me ma respektu kohën se është e jemja.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Kohën jashtë rendit të ditës a? Je duke e shkel ligjin, je tu e shkel edhe rregulloren e kuvendit i nderuar, por ti po donë me polimizu, polimizojmë, nuk është problem, edhe unë e lypi fjalën e polimizojmë.

**z.Jakup Demiri:** Nuk jam duke e shkel rregulloren, cilën rregullore.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Nuk ke të drejtë jashtë rendit të ditës ti me disku qe 3 here.

**z.Jakup Demiri:** Ne ende nuk kemi hyrë në rendë të ditës.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Nuk po të konvenon me hy në rend të ditës, se me hy e ki raportin më të mirë të pasqyrave financiare në historinë e Vitisë, por ty nuk po të konvenon.

**z.Jakup Demiri:** Ne këtu jetojmë kryetar, krejt muhabetet e kafeve (**nuk dëgjohet**), a u kuptum, kohën që e kam është e jemja, duhet me ma respektu.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Jo nuk ke kohë hiq, po kryesuesi nuk duhet me ta leju fjalën 3 here o zotëri, 3 here jashtë rendit të ditës. Ti je tu e shkel rregulloren.

**z.Jakup Demiri:** Këtë ligj nuk e ka bërë Vetëvendosja, por e ka gjetë dhe e ka zbatu.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** E ka bërë bash ministri i Vetëvendosjes, me qëllim e ka bërë. Me të tregu bash drejtë, bashë Vetëvendosja e ka bërë, me të tregu të drejtën e ka shkel edhe ligjin.

**z.Jakup Demiri:** Ku e ka shkelë ligjin?

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kemi një propozim nga Lëvizja Vetëvendosje, që të hynë në rendë të ditës edhe pika për faljen e tatimit në pronë në vlerë prej 100 euro. Kush është që kjo pikë të hyjë në rend të ditës? Kush është për? 7 vota për. Kush është kundër? 15 kunder. Nuk hynë në rend të ditës. Kush është që të miratohet rendit ditës me ato pika çka i kam propozu unë? 15 janë për, kundër janë 7, abstenim nuk ka, vazhdojmë me rendin e dites.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal**

**z.Musli Neziri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Tek procesverbali kryesues kam reagu për këtë çështje edhe në seancën e kaluar, ka disa gabime që po përcillen vazhdimisht. Nuk e di pse prapë reagimi është i njëjtë, emri i deputetes, këshilltares Zyrafete. Mbiemri i mungon. Pastaj tek fjalimet e mia, ka disa fjali që spërputhen kërkund me atë që është thanë e me atë që është thanë dhe çka është shkru. Përshembull në faqen numër 8, tek replika ime është në rreshtin e 4-ër, është shënuar regjistroj. Realisht aty është thanë respektoj. Faqe 11, tek fjalimi im, prapë aty është përfillen, s'kum thanë përfillen po përseriten. Faqe 12, prapë te fjalimi është sipërfaqjet, domethanë s'pe di bre çka është, s'po spërputhen, kështu që, gabimet aty ku janë për fjalimet e mia po flasë, kam has që prapë njëjtë, po çka më erdh te shënimi i emrave me mbiemra, aty tek 27 këshilltarët që jemi, domethanë aty prapë nuk janë shënu as emrat. Mirë, s'po na shënohen, domethanë s'di pse po shkoni copy paste, përmirësoni niher ata emra, pastaj përcillen. Veç kush mungon. Faleminderit për këto, e pata për procesverbal!

**z.Jakup Demiri:** Unë po e shfrytëzoj mundësinë, vetëm pak se nuk më le me kry fjalën. Më së pari në rend të ditës për pikat. Unë nuk e di që ka rregullore që lejon kryetarin apo dikush jashtë këtij domeni që është, se kjo është punë për asamblen komunale të diskuton, kështu që edhe kryeatri ja u ndihmojë këtu, meqenëse nuk ka pasë nevojë.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Ti po më akuzon mua me emër me mbiemër. Çka je ka fletë ti nuk ke të drejtë ashtu. Bëhu pak parimor, nuk ki të drejtë me më akuzu drejtpërdrejt, ti rregulloren je tu e thy Jakup, nuk ki të drejtë me më akuzu fillimishtë pa të bë asgjë.

**z.Jakup Demiri:** Çka të akuzova unë ty.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Jo ti, por këshilltari yt që po mbron ti po e mbron si shef i grupit parlamentar. Ti nuk ki të drejtë, unë kam të drejtë në replikë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nëse ke diçka për procesverbal, duhet të diskutosh për gjerat të tjera, i pret pikat e rendit të ditës dhe kemi mundësi për diskutim.

**z.Jakup Demiri:** O Bek, nuk zgjasin pazaret pafundesisht, po të them bash në sy. Rregulloret vlejné për të gjithë, më së pari duhet me respektu ti rregulloren kur të fol dikush, me ndegju se, është pjesë e muhabetit tem. Kohën të cilën nuk ke të drejtë as ti as kërkush në botë me ma cenu kur të flasë unë, kur të flasë unë kryetar duhesh me ndëgju, jo unë në cilësinë, por kushdo që flet e ka kohën e vetë respektoja se e respekton veten, ndërsa tek procesverbali pajtohem me kolegun Muslin, për shkak se është kogjo njoftim i mirë ta dimë se ku është ajo parcelë. Unë e kam pas një here një takim me një qytetar në Budrikë, i cili ka pasë pengesa në kryerjen e punimeve të tyre nga ara në parcelën, pikerishtë për atë unë e kam thanë pikerishtë për atë se komuna ka dhanë një parcel në shfrytëzim sipas qytaterit dhe pengesat që janë bërë nga ai që e ka marrë këtë parcelë nga komuna në shfrytëzim, nuk e ka lanë më të kalojë ajo pjesë, nuk është kërkund, del e pa kuptimtë kjo në faqen 12.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Kuvendi komunal planin rregullativ e ka miratu, nuk e ka miratu qeveria, duhet me mbrojtë vendimin e kuvendit komunal që ke miratu me shumicë votave. Është miratu vendimi i gjykatës është bërë më vonë.

**z.Jakup Demiri:** O kryetar, e dimë a i njef këto sene a i s'i njef, a po kuptonë.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Unë jam argumentues, merre qyre nëse nuk është kështu.

**z.Jakup Demiri:** Pse po del prej teme pra po qel muhabete. E dimë ne se sa jemi parimor, ky vend, këta njerëz, se këtu jetojmë për parime. Mundesh me qenë kogjo poshtë për me fol për parime.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Atëhere qe ku jan këshilltarët, qeveria, shko merre vendimin për planifikimin rregullativ është bërë më herët se sa vendimi i gjykatës. Vendimi i gjykatës është më i vonshëm.

**z.Jakup Demiri:** Qe ku i ki prej auditorit punët e tua që nuk i ke kry, qeto janë punët e tua, nuk janë të qeverisë, a ti bi lexoj, se po më vjenë zor edhe me t'i lexu se nuk po ndalesh. Tani qëto janë punët e tua që nuk i ke kry e po mundohesh të qeveris me i kry qysh po shkojnë tenderat nëpër Viti, punsimet qato janë punët o kryetar, po mos të hym andej.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Jo hym edhe te shkrimet fantome, Blerim Kabashi, dje që i keni bë, himë ndesh jashtë temës.

**z.Jakup Demiri:** Kush i ka bë?

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** I kanë bërë këshilltarët e juvë.

**z.Jakup Demiri:** Qoj more ku është vendi.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** I qojmë, e dinë edhe ti se kush i ka bërë, jeni tu e ditë fortë mirë edhe për atë jam tu e dashtë me të njëjtë gati edhe me të thanë që bollë je tu i shkel rregulloret edhe kryesuesit i kam thanë, duhet me punu me rregullore, nuk mundesh ti si në odë me qendru me thy edhe me shkru, me i thy njerëzit edhe familjet nuk mundesh. Po e kërkoj fjalën edhe një here si kryetar komune, nuk kisha ndërhy sikur mos të shkelet rregullorja e punës. Ka 3 here pa hi në rend të ditës nuk ka të drejtë me rregullore të punës këshilltari me marrë fjalën. Unë nuk e morra, por u apostrofu emri jem si kryetar, plus është apostrofu emri im dje në fantom shkrimet, sërish të Blerim Kabashit, nga të njëjtit njerëz është përmend e njëjta situatë. Nëse kuvendi e respekton rregulloren unë edhe 5 here ka me respektu.

**z.Jakup Demiri:** Kryetar, a je tu e ditë çka je tu thanë me qet Blerim Kabashin, a je i vetëdijshëm, je tu bë akuzë publike, shko te vendi.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Kemi shku, mos ke gajle hiq.

**z.Jakup Demiri:** E qëtu deklarohu, edhe unë po deklarohem se, vij te vendi e tani shihemi aty, akuza publike me bë përë këtë punë nuk është në rregull.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me ngritje dore kisha kërku miratimin e procesverbalit më permisime të këtyre çka është kërku. Nga të gjithë është miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës është:

## **2. Informatë (raport) për punën e kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2022**

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Fillimishtë është bërë prezantimi i punëve për periudhën Janar-Dhjetor 2022 përmes audioingjizimit. Ka pas aktivitete edhe të tjera që i kemi bërë në vitin 2022, në vitin më të suksesshëm të Vitisë që ka pasë në të gjitha standardet edhe aktivitetet. Sigurisht pasqyrat financiare pas informatës do ta japin rezultatin. E dij që i keni pas në dorë të nderuar këshilltar, të nderuar kshilltare, për shkak se, të gjitha parametrat i kemi më të mira në Kosov, qoftë për investimet kapitale, qoftë hargjimin e buxhetit të përgjithshëm, qoftë të hyrat vetanake, tu e përfshi edhe tatimin në pronë, rregullaritetin ligjor, auditorë, te procedimi i grandit, performances, por edhe te transparenca, për shkak se ky dokumentar është një lloj transparence, se të rikthen në aktivitetet që i kemi zhvillu gjatë vitit 2022. Përshembull aty nuk e pashë ardhjen e 8 ambasadorëve të vendeve mike që kanë qenë në Viti për 1 ditë, por ka edhe shumë aktivitete të tjera. Vërtet viti 2022 ka qenë i përmbushur me aktivitete tu ju falënderu të gjithëve, e falenderoj ekipen time, qeverinë komunale, zyrat, të gjitha veç e veç, por edhe kuvendin që me propozimin e qeverisë ka aprovu vendimet me interes të Vitisë. Prandaj i nderuari kryesues, faleminderit edhe ty për bashkëpunim, bashkëpunimin edhe të nënkryetarit, i cili nuk është këtu për shkak se ka rast vdekje, për të gjitha sukseset që i kemi pas të përbashketa për vitin 2022. I vit i plotë është bërë prej kur unë e kam marrë besimin e qytetarëve për mandatin e 3-të, për të udhëhequr në komunën tonë. Ky vit u karakteriziu me suksese në të gjitha segmentet që janë në fushëveprimtarinë e komunës, janë pjesë tjera, kemi pas problematika të ndyrshme. Unë mund t'i sqaroj veç e veç edhe atë problemin që e ngriti këshilltarja më herët, unë mund ta diskutoj natyrisht një debat argumentues dhe parimor, përndryshe nuk jam i interesum për debate jo argumentuese. Ajo çka kisha primare që në fillim të mandatit të parë, ishte t'i i përgjigjem kërkesave të qytetarëve që për neve ishin edhe udhërrëfyes për projektet e përbashkëta programore. Realizimi i tyre i suksesshëm nuk ka munguar as në vitin të cilin po raporotjmë. Me këtë po dua të them se, ne kemi pas një orientim të cilin po dëshirojmë me zbatu në përpikshmeri. Viti 2022

karakterizohet si një vit jo vetëm i suksesshëm, por edhe me shumë angazhime dhe reprezentime të komunës sonë dhe me shumë miqë dhe me shumë projekte dhe shumë grande të performancës që i kemi fitu si Komunë, e shumë projekte të tjera. Matrialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit kryetar. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ali Bajrami:** Faleminderit kryesues! Të gjitha ato çka janë punu për qytetarët dhe në të mirën e qytetarëve i pamë përmes video ingjizimit, është bërë një punë e madhe, një punë me përkushtim, një punë me përgjegjësi të plotë. I spjegoj kryetari, mos me ju marrë shumë kohë, por nëse himë të gjitha punët, aktivitetet që janë bërë, duke fillu nga zyra e kryetarit, drejtorëve, është bërë një angazhim që viti 2022, periudha kohore Jana-Dhjetor të përmbillet dhe paraja që ka qenë në dispozicion të shpenzohet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe nëse e ndalim dhe e analizjomë përqindjen e shpenzimeve, atëhere jo të kënaqur, por duhet të jemi shumë të kënaqur, se është dikund 98.52%. Me hi nëpër drejtori, kisha fillu prej bujqësisë, ku fermerët e vyshem të komunës sonë janë furnizu me sperkatëse, me shperndarëse të plehut, makina mbjelëse, të gjitha me një koordinim, me një konsultim me fermerët, për atë çka kanë nevojë. Nëse marrim te Drejtoria e Arsimit, kemi, furnizimi i shkollave me inventar, rregullimi i hapësiarve gjelbëruese, rregullimi i fushave sportive, që për ata djemë dhe vajza kanë qenë një stimulim dhe një rritje e aktivitetit për tregimin e talentëve dhe të ardhmen e tyre që e kanë përpara. Drejtoria për Kulturë dhe Sport, është bërë subvencionimi i të gjithave, i shoqërive kulturo-artistike dhe klubeve sportive që janë dhe funksionojnë në Komunën e Vitisë, ka qenë ajo vlerë diku 50 mijë euro, por ajo ka qenë dhe është shpërnda, dhe falë kësaj shpërndarje edhe aktiviteti i tyre nuk ka mungu. Në shëndetësi nga të hyrat vetanake në bashkëpunim me operatorin janë bërë blerje nga të hyrat vetanake, vlera dikun 99 mijë e 500 euro. Krejtë kjo për fundë te investimet kapitale, i pamë investimet në infrastrukturë rrugore, ndriçim, kanalizim, në një mënyrë vetëm çka është një e metë që të kishim pas pare më shumë kishim bërë punë edhe më shumë. Kjo është që duhet të bëjmë përpjekje të i rrisim të hyrat vetanake në të mirë të qytetarëve të Komunës së Vitisë, të ja bëjmë jetën dhe t'i japim kuptim asaj për çka janë ata që janë duke e paguar obligimin ndaj shtetit, ndaj komunës që e kanë.

**z.Jakup Demiri:** Faleminderit kryesues! Përshendetje prapë për të gjithë! Unë po lidhem pak edhe me filmin që e pamë këtu, edhe me raportin e kryetarit. Më së pari kryetar raporti nuk vjenë në KPF. Tek faqja numër 3, e kam një pyetje, ku shkruan këtu, fokus të veçantë i kemi dhanë arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës në përgjithësi, por edhe si resurve të tjerë përgjithësisht. Prapë uji i pijes nuk është në komunën tonë prioritet. Nëse elementi bazë më i rëndësishëm i njeriut në përgjithësi është uji i pijes, e kemi ngritë vazhdimisht zërin, është viti i 5-të këtu i imi që jamë në asamblen komunale dhe prapë po e shof që e keni edhe në dokument, që e dokumenton që nuk është uji i pijes prioritet. Ndërsa në vitin që lamë pas, po lidhem me 2021, kur ishte koha e zgjedhjeve, diku 24 ujësjellës sipas emisioneve televizive janë kanë të funksionalizume, e ata e dimë që nuk kanë qenë, por ka qenë koha si ka qenë në vitin 2022, komplet këtij viti nuk e pamë edhe në filmin, duke u shfaqur dikund një qeshmë e ujit që keni bërë diçka që keni pre një shiriti për ujë të pijes, e na e dimë që gjendjen e kemi kogja keq në ujë të pijes. Të gjitha investimet e tjera besoj që nuk arsyetojnë këto investimet kur nuk e ke prioritet ujin e pijes, kur ne duhet të ballafaqohemi, ende të hapim bunare, puse për pije nëpër fshatra. Diku mundem të them që 30 puse të ujit të pijes janë hapë vetëm në fshatin tim Smirë vetëm në këtë vit, kqyre koston, kqyri këto 4-5 vite që jemi vonu, që na e lidhshi strategjin me atë zvicrane, edhe që ka qenë gabim. Këtë e ka pranë edhe nënkryetari me një debat që kena mëndu, këna shpresu, këna besu, nuk na ka dalë ashtu. Tashti po e kthejmë knej, po ky debat ka qenë tashti 1 vit me nënkryetarin, pavarësisht se tasht ai nuk është këtu dhe nuk është mirë me fol kur nuk është personi adekuat, por tema është ajo, ka procesverbal dhe ka ingjizime. Do të thotë nuk jam duke e bërë që ai nuk është këtu, po ai ka premtu që vitin 2022 është vit në prioritet për ujin e pijes në komunën tonë e që këtu edhe me dokument e kemi tashti që nuk paska qenë ashtu. Në fokus Komuna e Vitisë do të thotë fokus të veçantë i kemi dhanë arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës në përgjithësi. Po lidhem te filmi këtu. Unë po jap si vërejtje kryetar, se pamë shumë ingjizime me takime ndërkombëtare, por e pash veç shkarazi nja 2 here, disa sekonda "Flakadani i Karadakut" dhe 1 vizitë tek varrezat e deshmoreve. Kryetar, të japi vërejtje, sinqerishtë që këtu kisha pas qefë me pa më shumë se ky vend, ky shtet, kjo komunë funksionon në bazë të gjakut të atyre deshmoreve aty që janë, se ndoshta mos e merr personale, por ka këtu që po hasem në muhabet, por dikujt ky shtet dhe ky vend ka ardh dhe e ka pru lejleku, por unë mendoj ndryshe. E kisha dhanë, po ta jap si vërejtje se, edhe këtë temë e shohin edhe qytetarët te varrezat e deshmoreve, edhe te deshmoret në përgjithësi mendoj që kur ti shohim krejt këto takimet e tjera që i kemi me ndërkombëtarët me vendor, do të thotë ky film ka shumë për të dëshiruar me shti në të, edhe pse nuk pajtohem me një pjesë të madhe të filmit. Pse nuk pajtohem! Nuk pajtohem sepse nuk po shof takime me këshillat e fshatrave. I keni mbajtë disa takime që thirren me qytetarë, edhe me këshillat e fshatrave për në Smirë. E di si e keni mbajt, e keni organizu për 1 orë ose 2 vetem me qitë në dokument kryetar, se atë ditë jam thirrë unë dhe ma kanë spjegju si është situata, por besimi është

hup. Po flas për fshatin Smirë, që i takoj këshillit të fshatit, se nja 3 here ren i kemi dorëzuar në komunë prioritetet, ato prioritetet të fshatit, asnjë prej tyre ende nuk kanë hyrë në projekte. Merre si vërejtje, takime me këshilla të fshatrave nuk pashë as në film dhe buxheti të ndahet për kokë banori, por me rekomandime dhe sugjerime të këshillave të fshatrave, se ne po e gjejmë edhe në disa administratorë të fshatrave që edhe nuk paguhen, por edhe nuk po i degjion edhe nuk po i pyet kush. Edhe te faqja numër 8, Zyra për Informim thotë: “ka përcjellë aktivitete të kryetarit të Komunës apo të zyrtarëve të tjerë komunal”. Këtu thotë me një vend që, disa here nuk ka funksionu Zyra për Informim. Është e vëretet që ne shumë here nuk kemi mujt, mirë që e keni shkjaru, por është mirë me shkjaru gjithë me kohë, se nuk e dishim ne a nuk është tu i publiku apo ku është problemi. Vërejtje. Edhe tjetra që, në këtë vit ka qenë pak më ndryshe situata. Veç kujtojmë që këtu janë votu buxhete të Kuvendit Komunal pa kamera, kemi pas sidomos viti 2021, ka qenë edhe vit zgjedhor këtu, ka qenë terr informativ, seancat e Kuvendit Komunal pjesën më të madhe nuk janë. Kemi edhe një pjesë të 2022-ës, asfaltimi i rrugës Mjak-Viti-Mjak. A është i emërum ashtu? Se nuk e di që prej Vitisë deri në Mjak asfaltimi i rrugës Viti-Mjak. Faqe 20, deshta me ditë a është donacion grand i qeveris dhe a është emrimi kështu? Se prej Vitisë deri në Mjak nuk e di që kemi qitë asfalt.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Emri Viti rruga e Mjakut, me memorandum domethanë është.

**z.Jakup Demiri:** Memorandumin e përmende, se the që kemi memorandume me organizata të ndyrshme dhe kemi memorandume edhe me qeverinë. Cili është memorandumit me qeverinë apo për ndonjë projektë për çka bëhet? Fjalën e kemi memorandum të nënshkrum. Se mesa e di unë, nuk kam dëgju cili është memorandumit me qeverinë. Kam edhe një pyetje, për faqen 23, te inspektorët e ndërtimit kryetar, janë disa objete këtu në Viti, që dorën në zemer këto objete të banimit që po ndërtohen, ata përveç se kanë kalu (**nuk kuptohet**) dhe punojnë sikur mos me pas këtu inspektor, ato mbindërtimet sikur kanë ndodhë më herët po ndodhin edhe tashti, po një që më shqetëson mua, se ka me na ndodhë. Unë kam parë që në katin e 9 e 10 sa e kanë qu ata pa mbrojtëse, pa siguri, pa kurgja hiq. Unë e di që dikush merr rrogë prej inspektorit të ndërtimit, e të paktën atë me dalë me kqyrë se, me humb jetën një puntorë është kogjo gjyna, bile ato pajisjet e sigurisë ne t'i bëjnë, se nderimin e dimë që nuk e ndalin ata, se është njëfar ujdje. Unë mendoj ashtu edhe një pjesë e qytetarëve. Nëse është ndryshe, atëhere veprime nuk kemi parë institucionale që të ndërpriten ndërtimet pa leje të ndalen. Këto i kisha, nëse ka ndonjë gjë nderlidhem prapë.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Faleminderit që pranove punën e mirë edhe aktivitete që janë zhvillu. Edhe dokumentarin një pjesë të atyre i ka thënë, vetëm një pjesë një pjesë që i kërkoj edhe Jakupi, nuk mundesh krejtë, se është dashtë me zgatë 5 orë, 10 orë. Ka aktivitete që ndoshta i kam mbetë borxh edhe zyrrave që kanë punu, që janë këtu prezent, që kanë punu jashtëzakonisht shumë, por i keni në raport më të detajume dhe mundeni të gjitha me i kqyr. Dokumentari vetëm një pjesë e ka paraqitë. Jakupi i ka ngritë një vargë çështjesh që janë me rëndesi edhe për neve, janë prioritet, janë për të gjithë bashkë. Është e vërtet që kanë qenë prioritet edhe janë, nuk është e vërtet që nuk jemi marrë me ato çështje. Pse nuk janë paraqitë në dokumentar, nuk do të thotë që nuk jemi marrë me ato aktivetete. Pse ka arsye arsimit prioritet, mund ta dokumentoj pse ka shëndetësia prioritet. Ne mundemi ta dokumentojmë pse ka bujqësia, mundë ta dokumentojmë pse ka infrastruktura, mund ta dokumentojmë edhe dokumentari e dokumentoj, por edhe ne unë mund të jap 10 shembuj pse ka administrata, reformimi i shërbimeve më të shpejta, edhe sidomos mobilizimi gjatë kohës mërgata kur po është, unë mund ta dokumentoj, megjithëse këto për shërbime respektet meritojnë edhe të tjerët që nuk janë në kuadër të komunës, që janë në nivel qëndror. Përshebull te pasaporta, te letërnjoftimet, që vërtet kryhen shërbime efikase, dhe unë i kam respektu dhe vizitu se janë në interes të shërbimit të qytetarëve të Vitisë. Sa i përket ujit të pijes, ki të drejtë që është prioritet dhe duhet me mbetë prioritet, por duhet me mbet prioritet edhe qeveritar. Edhe unë kam qenë në grand atë ditë në takim kryeministrit, i kam thanë që duhet me qenë mbulushmëria e ujit të pijes, trajtimi i ujrave të zeza duhet me qenë në të gjithë Kosovën. Kemi fol për 24 ujësjellëse edhe sot, t'i dokumentoj që kemi fol edhe e kemi punu në këtë drejtim. Përshebull kemi fol për 5 fshtara, 2 Sllatinat, 2 Sodovina, Trestenik, bëjnë 5 fshtra, që shumë shpejtë tashti e kemi rergullu gati manganin, shumë shpejtë do t'i përurojmë, edhe “Hidromorava” sipas memorandumit që kemi 3 palsh, donatorë-Komunë-Hidromoravë, ka me marr nën kompetencë, shumë shpejtë do ta keni, por tashti krejtësisht “Hidromorava”, për shkak se komuna, e keni parasysh edhe me vendimin e Kuvendin Komunal, i ka kry obligimet e veta, ne nuk kemi obligim aty, por tashti ne nuk mundemi me i thanë qytetarëve nuk kemi obligim dhe ne nuk i ngucim ata, derisa ta kryen punën, por unë jam duke mbajt takime javën e kalume me drejtorin e ri dhe me kryetarin e bordit të “Hidromorevës”, që është zgjedh i riu Habil Zeqiri, edhe me drejtorin e “Hidromorevës” të riun që është zgjedh, ka qenë ish drejtor banke në Viti, Tashti është drejtor atje. Kam pas takim dhe shumë shpejtë për 5 fshatra unë nuk po du me thanë brenda muajit, por deri në seancën e ardhshme do ta kemi rezultatin. Besoj, por këtu jemi bashktë të gjithë, ai ujë ka fillu edhe me ish kryetarin, unë i kam kry obligimet, por i kam kry obligimet me propozimin e qeverisë edhe me miratimin e Kuvendit Komunal, nuk i kam kry vet ato para, janë të taksapaguesve, mirëpo edhe nevoja është

e qytetarëve të Vitisë, që të kenë mbulueshmëri me ujë, nëse atë ditë e bëjmë memorandum, unë ju ftojë me qenë së bashku, së paku ju shefat e grupeve parlamentare bashkë me ne dikasteret profesional përkatës, lamive, por dijeni që në këtë punim jemi tu punu nën 1, ndërsa nën 2 Gërmovent e kemi lëshu, por në këtë kur ka qenë Goshicën nuk e kemi lëshu, ne me kryetarin e fshatit kemi bisedu, duhet me kërkim që edhe Goshicën me mbulu me ujë. Në anën tjetër kemi punu për Smirë, për Verban 5, edhe 2 bëjnë 7. Edhe Smira, Verbani 9, kemi një problem vetëm me KEDS-in që do ta zgjedhim shumë shpejtë, edhe besoj që me çështjen e ujit do të rregullojmë, ka aty probleme teknike, operacionale, aty pak në gypa dikun dikun defekte, por që detyrim e kanë jo komuna, por kompania implementuese me kry bashkë me donatorin e "Hidromorava", natyrisht sipas memorandumit me i marrë nën mbikqyrje edhe Goshicën edhe Smirën, Podgorcin, kemi pas probleme me bazenin për shkak të pronës, shtrirja e gypit është bërë në Dobolldëh, është bërë shtrirja e gypit, por ujë nuk ka të mjetfueshëm për shkak se në Dobolldëh janë rrit shtëpitë tashti, villat janë rrit jashtëzakonisht shumë, tashti duhet me gjetë edhe një burim të ujit për me shtu që Dobolldëhu me pasë ujë të mjetueshem, Letnicën e kemi lëshu u bënen 13, Stubllen e kemi afër me lëshu shumë afër, Leonardi qenka këtu, është çështja edhe me kryetarin e fshatit jemi në rrjedh, edhe besoj që ne i kemi kryer obligimet edhe me vendimet e kuvndit komunal që i kemi propozu i kemi kry obligimet financiare, domethanë nuk është që nuk jemi marrë. Zhiti, ju e dini që uji është në bazent ka ujë sadush "Hidromorava", duhet me marrë obligimin e veta, ka qenë krejtësisht në obligimin i hidromoraves, me marrë në mbikqyrje, domethanë komuna i ka kry obligimet e veta. Në Skifeteraj është e vërtet që uji është lëshu, problem i rrjetit të vjetër ku me ditë sa vite i ka që është ndreq edhe ka probleme aty brenda nëpër fshat rrejt, që "Hidromorava" duhet me i zgjidh me marrë në mbikqyrje. Edhe ka garant nivelin regjional që ka me marr për shkak që është e percaktume edhe me ligj. Begunca ka ujë, ujë prej burimit vjen në Beguncë, ndoshta për gjysmën e Vitisë ka ujë objekti përponues që është ndreq, natyrisht për shkak të mos përpunimit kur nuk ka pas rrymë, atëhere e kanë lanë pa agregatë që nuk është ajo përgjegjësi e jona, edhe tashti e ka mush me lym, tashti pastrimi atje, kemi punu në nivel atje fazën e segmentit atje naltë, kanë fillu orët, e kanë pengun një pjesë. Sa i përket orëve, faktikisht për shkak se shiko, ne nuk i kemi qare pa ja dorëzuar kompanies e cila trajton ujin, e mbikqyrë, e klorifikon Hidromoraves, edhe në mënyr që me pas vërtet aspektin e kontrollum të ujit edhe kualitetin edhe me pasë bollshmerinë. Jemi tu punu edhe për fshatrat e tjera, por ju e dini që ujit me gypin e ri prej Letnicës vitin e kalum është lëshu në fillim të vitit, faktikisht është bërë edhe promovimi, ne pse nuk e kemi lëshu në aktivitet, ju e dini pse, se 1 vit më herët ka fillu, nuk kemi dashtë me përserit, por këto kanë qenë projekte 2 vjeçare, nuk ka qenë historike gypi i azbestit me u ndrru prej Letnicës deri në Viti me buxhet komunal e kemi ndërru. Ai buxhet nuk është i imi, është punë e përbashkët që e kemi bërë. Në anën tjetër kshilltar, në Shtator ju e keni votu buxhetin dhe në atë buxhet ekziston uji Radivojc-Devajë, Ramjan-Fshati i Ri, është i buxhetum edhe plus e kemi për rritje të kapacitetit një buxhet shtesë, që kemi bërë një kodë buxhetor, e keni kodin buxhetor që kemi bë. Sigurisht drejtori Besniku e ka, e kemi bërë për shtim të kapaciteteve të ujit, por në anën tjetër e kemi një risi që na ka dal vitin e kalumë pak, qëky projekti i bankës botërore FLO që po quhet, që nesër faktikisht e kemi në ora 11:30, takimin për rritje të kapacitetve të ujit jo vetëm në Gjialan por edhe Vitinë e ka përfshi. Takimi ka me u bë transparent, domethanë nuk është që nuk kemi punu, por a kemi nevojë për mbulueshmëri të ujit, vërtet kemi nevojë shumë. Një gjë tjetër se, po i bjen sikur mu adresu qëtashti, për shkak se direkt qeverisjet i kanë fajet. Për sa i përket ujit të pijes, edhe mbulueshmërisë me ujë, i bie që Qeveria Qendore me Zyrën Zvicrane, me Zyrën Seko që quhet, e ka pas financimin e aspektit të ujit edhe mbulueshmërinë me ujë të pijes dhe ata i kanë nda. Mundem mi tregu edhe nëpër faza, për shkak se unë nuk kam qenë pjesë e asaj faze. Në atë kohë nuk kam qenë kryetar por e di se kam qenë shumë i informumë kur qeveria i ka dhënë 9 milion dhe 8 milion i ka dhënë SEKO, kur 9 miliom i ka dhënë Zyra Zvicrane për Investime, 8 i ka dhënë Qeveria. Edhe sot Qeveria dhe Zyra Zvicrane janë financuese të këtij projekti, kan punu me kopmani regjionale që janë të themelume me ligj nga Parlamenti i Kosoves, prandaj në këtë kuptim ne i kemi problematikat të cilat faktikisht na u kanë kriju sikur na u kan kriju me lumenjtë që i murrën në krejtë Kosovën vërshimet, tashë e patë edhe përroskat na u vershun përshkak se lumenjtë i ka ministria e ambientit në mbikqyrje, etj etj, e problematika. Ne jemi mundu në kuadër të këtyre suazave, por ky trekëndësh neve na qetë faqebardh, se komuna i ka kryer obligimet e veta si Viti, sakt i ka të kryera edhe buxhetore, prandaj unë mundem edhe me ja u dokumentu. Zyra Ligjore e jona e ka bërë edhe një dokumentacion që ja ka dërgu "Hidromoravës" komplet me faza kur i ka kry Vitia për këtë aspekt, prandaj ne presim edhe refleksione pozitive. Sa i përket ujit, kjo është te dokumentari. Nuk kam më shumë çka me thanë se kemi mujt shumë më shumë me shti, por me të vërtet u stergjat edhe pse unë nuk kam ndërhy hiq këtu, janë prezent sepse janë pjesa profesionale e Zyrës së Informimit, që unë apsolut, as në zyre nuk kam qenë, as në televizion apsolut nuk kam ndërhy. Unë nuk ndërhy në kësi raste edhe kur shfaqen dobësi, për shkak se edhe ato janë oregjinale, edhe dobësitë janë normale. Ne është me rëndësi me punu dhe me i mbërri dispozitata të cilat na u përcaktohen me ligj. Edhe DECDI e kam shënu këtu, por unë deshta me spjegju kush është donatorë, DECDI

është implementues, prandaj ata është dashtë me i kqyrë qeveria korrektuese, se kanë komitet drejtues të kontrolles mbi implementimin e projektit. Te homazhet, pak kam paraqitë, përndryshe si qeveri, si institucione bashkë me kuvendin jena mundu pikë për pikë me i ndejtë me përgjegjshmëri serioze, krejt dokumentet i kemi, mundemi me bë për atë vetëm një dokumentar 1 orë, veç vetë nuk besoj që ka Qeveri Komunale në Kosovë që ka mujtë me i nejt qysh i kemi nejt ne edhe për atë ndihem krenar institucionalisht, se kemi qenë tepër të përgjegjshëm edhe të saktë, edhe me minuta edhe pse kemi pas pak ndihmën e zyrave të cilat paguhen edhe janë të themelume për këtë punë, sepse ka zyre të cilat nuk i kam formu unë, por janë të themelume për atë punë me u kujdes, me u organizu edhe me ju pri, por unë i kam nejt bashkë me bashkëpunor, me qeverinë komunale edhe kryesuesi, që janë këtu edhe ish kryesuesi, por po ju tregoj që kemi nejt me përpikëmeri, edhe pse unë jam për një orientim tjetër. Unë jam për me i respektu Ditën e Dëshmorëve - 5 Majin, unë jam për me respektu Ditën e Pavarësisë. Unë jam për me respektu ditën e qlirimit, unë jam për me i respektu kalendarët shtetror që na bëjnë nder të gjithëve institucionalisht, e këta tjera apert po kthehem, janë popullizëm, janë nderim, por nderimin e bëjmë në mënyrë institucionale, statutalishtë edhe me ligj qysh është ligji i miratum në nivel vendi dhe po tregoj që kjo tjetra është tu na shkakto probleme edhe inibicione në shumë aktivitete institucionale, dhe si institucion unë kërkuj që krejtë bashkë me kanë edhe me respektu kalenderin statutor edhe ligjor këtë po e them dhe po e them guximshëm. Ne në fakt kemi pas vërtet përgjegjshmëri për të gjitha aktivitetet, takimet me kryetarët e këshillave të fshatit, i kemi mbajtur të rregullta edhe sot për planifikim, jemi duke i mbajtur, jemi tu i thirrë, edhe pse planifikimi ka kalu në kuvend, jemi tu punu me planifikues me inxhiniera edhe sot i thirrur dhe bashkëbisedojmë, e keni ftesën e kshilltarëve me marrë pjesë në vendbanimin ku jeni përshembull për Smirë kemi mbajtur takime preliminare, por kemi mbajtur takime zyrtare edhe me kryetarin e fshatit drejtori që është nga Smira, i financave, është këtu dhe kryesuesi është këtu nga Smira dhe ju që jeni kshilltarë jeni të thirrur në takim, gjatë numrimit të projekteve 2 vjeçare këtë vit që janë të miratume në buxhet del se, për Smirën po ta jap këtë përgjigje të saktë që, ta argumentoj tashti, mundem me thirr inxhinierin e Smirës që është në planifikim 13 projekte janë që vetëm kanë me vazhdu mundem edhe me ti numru, se edhe i di dhe plus planifikimin e ri që kemi me bë tashti bashkë për të gjitha janë i hapur me bisedu, sikurse kemi folë në kuvendë që mos me mbet buxheti që është planifiku prej 1 njeri as zgjedhje nuk ka e bëjmë bashkë dhe kshilltarët për vendbanimet e juaja, secili e keni të drejtën, urdhëroni, pa dallime partiake kemi me u bë bashkë me kryetarët e fshatrave, edhe ata pa marrë parasysh kryetari prej nga vjen është kryetar fshati, është institucionalisht i pranueshëm edhe bashkëpunues dhe kemi me punu me të gjithë bashkarisht sikurse kemi punu me kryetarin e Fshatit të Ri, sikurse me të Smirës, Stubllës, me të gjithë kemi me punu, por edhe këshilltarët, për shkak se keni marë votë, mbron interesat edhe i kqyrem bashkë për ato projektet të cilat i fusim tashti, e kam fjalën për vitin në vijim. Prandaj Smira e ka prioritetin e vetë, tu i përfshi edhe projektet tjera psh: te palestra sportive që bëhet, poligoni i atletikes prej rrugës së Smirës edhe Drobeshin, natyrisht edhe Gërmoven që del për Sllatinë. Fusha e tenisit, zgjerimi i rrugës Drobeshit që ka me u bë, që del pas varrezave të dëshmoreve te rruga alternative, te ura, te rruga "Shaban Shabani" apo si quhet, trotuari etj. Te Web faqja nga nivelet qendror atje ka pas problematika. Mustafa qenka këtu, buxheti 2021-2022 ka pas projekte edhe ka projekte. Projektet janë në vazhdimësi si viti kalendarik sportiv që është 2023-2024, është edhe buxheti, miratohet në Shtator, implementohet në Korrik, është qështje që vazhdon. Rruga e Mjakut edhe memorantumet që lidhen po kemi memorandume t'i shpjegoj secilat, memorandum me ministrinë ta keni një gjë parasysh janë lidh më herët rruga Mjakut, është lidh sa ka qenë ministër Abrashi, mandej zv.ministri na ka detyru me rilidhë edhe njëhere memorandumin, unë në mënyrë institucionale për interes të qytetarëve kam pranë, edhe pse e kam thanë mendimin tem, ja kam thanë edhe kryeministrit. Ministri i financave ka qenë shumë në mënyrë parimore institucionale me shkëput memorandumin që e nënshkruan kryetari me ministrinë e me nënshkru me zv.ministrinë. Mua nuk po më duket, përshkak se qeverisja ka vazhdimësi ato projete çka ish kryetari, Nexhmedin Arifi i ka lanë. Unë i kam vazhdu, përshembull projektin e shkollës së Sllatinës, Ballancës, projektin e kanalizimit të Tërpezës, Smirë, unë i kam vazhdu detyrimisht edhe pse nuk kanë qenë planifikime për vitin e ardhshëm, sepse qeveria është në vazhdimësi ka memorandume edhe të tjera, memorandume të reja, nuk ka asnjë projektë të ri, nuk na e kanë dhanë, ky është fakte, por unë e kam kërkuj që bile projektet të cilat i kemi memorandumet e më hershme me u përfundu. P.sh.: memorandum për zonën ekonomike, që është tepër e rëndësishëm, jo vetëm për Vitinë. Unë kisha thanë që këshilltarët e kuvendit komunal, edhe ju të Vetëvendosja duhet me qenë me kryetarin, me kryesuesin, qeverinë, me të gjithë që zonën ekonomike me qu përpara, jo qe 1 vit buxheti i miratum mos me punu, se edhe ajo është një llojë shkelje. Ne normalisht që nuk është në kompetenca tona edhe në mbikëqyrje, shkolla e Pozheranit është në mbikëqyrje të Ministrisë së Administratës Publike Ministria nuk është tashti, por Ministria e Punëve të Brendshme mbikëqyrjen e ka, dhe financimin. E qesin, e anulojnë, e tenderojnë, e anulojnë. Unë kam kërkuj që ju duhet me më përkrah që me kalu në Ministrinë e Arsimit, që është barrë, se edhe buxhetin e ka, edhe tek e fundit ligjerisht strumbullari i organizimit arsimor në Kosovë, në vend që

është me ligj ose me ja dhënë komunës përfituese që ne me kry më shpejtë, kjo ka qenë kërkesë institucionale legjitime. Ju a e kundershtut apo nuk e kundershtut. Prej se ka ardhë kjo qeveri, shkolla e Pozheranit është ndal, është kanë tu punu ngaldal ajo mos me u kanë tu punu nuk ish ardhë në këtë gjendje ajo, shihet është ndalë. Mua si kryetar nuk po më interesojnë problemet politike, juridike, mua po më intereson shkolla e Pozheranit mu rregullu, dhe tashti unë nuk po mundem me ndërhy, se nuk e kam as buxhetin, as mbikëqyrjen dhe unë mundem me garantu me i kriju kushte dhe parakushte çfarëdo qofshin në emër të qeverisë, që shkolla e Pozheranit çfardo që kërkon ministria dhe qeveria me shku përpara. Mos past ministri kohë ka sekretari permanent, organizimi shtetor është i ditun mirëfilli. Sekretari permanent e ka pjesën ekzekutive profesionale, i cili duhet me i shty problemet. Nuk po e di as kush është, vetëm unë e di l që, unë e kam ngritë mbi 100 here zërin për shkollën e Pozheranit, ndërsa asnjëhere nuk më kanë thirr me bisedu për atë shkollë, këtë ja kam thanë edhe kryeministrit. Domethanë nuk jam tu e ngrit për shkaqe politike shkollën e Pozheranit, as unë as ju. Për stadium të Pozheranit, edhe për palestër. Ne kemi pas takime me Ministrin e Kulturës, ka qenë edhe drejtori i kulturës, është këtu prezent dhe ka pasë të tjerë 20. Vet kemi qenë në sallë, ne jemi dakordu me ministrin i cili mu ka dokë shumë i kulturum, i qasshëm, ka ardhë sikur që ka ardhë edhe ministri i bujqësisë. Aty ministri ka thënë që unë ju garantojë që çmimet ka me ju pagu të rritjes firmave. Në të punojnë, mandej firmat kanë thanë ne të na jep me shkrim, por nuk na ka dhënë dhe e dini përgjegjen e tij në Parlament, përgjigjja e ti në Parlament. Nuk ishte e vërtet ajo çka ka qenë në sallë, çka kanë ndëgju e kanë parë 20 vet, veç mos harroni, para kësaj në qeverisje e kam pas edhe LDK-në, por ju e dini mirë kur ka qenë nevoja me mbrojtë regjionin, unë ja kam lëshu Lutfi Zharkut takimin te Vali Rangj, ka qenë edhe Lutfi Haziri atë kohë kryetar Gjilani, e kam mbrojt Gërlicen dhe projektin e autostradës Gadimes me pru në Ramjan, ku lidhemi 3 komunat dhe krejt sektori i lindjes. Unë kam qenë decidivë për këtë punë dhe e kam lëshu. Nuk është problemi që kam qenë partiak, a që jam partiak. Këta e dinë që janë prezent kur me Mujoten jemi përta për çështjen e Gerlicës, në zyrën time. Kur ka qenë Pal Lekaj ministër, ai ka qenë zëvendës ministër. Profesor, u ngritën 10 pyetje, nuk është problem, nëse je i gatshëm me ndëgju në rregull. Unë po e themë edhe këtë fjali, i bie edhe më shkurt, nuk është problem. Faleminderit shumë për korrektesinë tënde të vazhdueshme, ka qenë vërtet vendimi i 2011-ës që na ka lanë neve pa kyq sektorin e lindjes, tashti e kemi problemin e anulimit të tenderit. Në atë kohë nuk ka qenë vetëm Vetëvendosja, edhe LDK-ja ka qenë në pushtet kur është bërë planifikimi, edhe PDK ka qenë në pushtet. Ne nuk po mundemi me diskutu parimisht si Kuvend i Komunës për interesin e Vitisë, por është anulu. Kur të anulohet jurista ka këtu me provojë edhe të tjerë. Po shofë këtu plotë kur të anulohet është obligim afat ligjorë me u ritenderu. Ne kështu e kemi, qështu e dimë, kështu punojmë ne në Viti, e për këtë kemi një ekpezitet krejt tjetër, e kjo duhet me u shtru në parim. Unë vetëm e thashë për këto projekte si është situata ndryshe, nuk është, kur kam qenë unë në takim me ministrin e LDK-së, ju e dini që kam organizu takimin me ministrin edhe me Pal Lekaj, ka qenë edhe grupi parlamentar i VV në takim ka qenë edhe PDK, ka pas deputet prej LDK-PDK-VV, ne mundemi prapë bashkë me i mbrojtë interesat çka janë kapitale, deficite. Edhe njëhere po themë, zonën ekonomike, palestrën, interesat e tona etj, edhe çështjen e ujit, mundemi me mbrojtë bashkë. Kjo është tepër me rëndësi. Inspektoret e ndëritmit nuk janë inspektorët e ndëritimit, se ka jurista, inspektori i punës duhet me kqyrë atë çështje, inspektori i punës është regjional. Nuk donë me thanë që inspektoriati i jonë mos me komuniku edhe mos me thirrë atë me kqyr, po edhe unë edhe ti, por inspektoriati i punës duhet me kqyrë në këtë aspekt. Taulant, më fal të lutem se patë shumë pika.

**z.Talunat Haxhiu:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë po e shofë që kjo seancë është shumë e rëndësishme, pasi që është raporti i kryetarit. Ne kryetarin gjatë mandatin që kemi hy, unë për të dyten here pe shof. Unë vetëm 1 here e kam taku, nuk ka qenë nëpër seanca. Unë e di që kryetari është personi më i rëndësishëm i komunës për të gjitha problematikat që i ka komuna. Unë e pash kryetar raportin, i pashë videot, unë po shofë këtu te faqja 19, na intereson neve, mua si shefë i grupit parlamentar. Të gjithë qytetarët e Vitisë, të gjitha projektet e investimeve kapitale të financuara nga buxheti i komunës dhe niveli qendror, nuk ka sqarime të mjaftueshme, a ekzistojnë vetëm emrat dhe projektet, kurse kostoja dhe punëkryesi i të gjitha këtyre projekteve, tu fillu prej asfaltimit të rrugës prej 1 deri 23 që i ke listu këtu, ne nuk kemi asnjë të dhënë se sa është kosto e tyre dhe kush është punëkryesi. Te zona ekonomike, pasi unë vij prej biznesit, unë e di që ajo ka fillu qe 4 vite, nuk ka qenë kjo në qeverisjen e Vetëvendosjes, kjo ka qenë prej qeverisjes së kalume, kjo ka qenë edhe kur ka qenë kryeministër z.Avdulla Hoti, por kjo me mbet vetëm të shihet, është hera e 3-të që unë e shofë në monitorë këtë dhe nuk ka asgjë konkrete për zonën ekonomike që është shumë e rendsishme për qytetarët e Komunës së Vitisë dhe të gjithë regjionit të Anamoravës. Kemi palestrën e Drobeshit, është viti i 9-të si kryetar i komunës që ti edhe në programet e tua zgjedhore ke thanë që, palestra do të kryhet. Unë tashti e kam një djalë, i ka bërë 9 muaj, po më duket që djali jem ka me hy në klasën e parë derisa të bëhet kjo palestër sipas punëve dhe ecurive të tashme. Ne e dimë që, ujësjellsit është shumë i rëndësishëm, unë po i cekim të gjitha për shkak se jemi në bashkëqeverisje siç kerkojmë prej teje llogaridhënie. Qytetarët besoj që

edhe unë jam i zgjedhuri i popullit. Ujësji në 2 Sodovinat, në 2 Sllatinat edhe në fshatin tëndë Beguncë, rrjeti është punu, por nuk është lëshu uji. Është qeverisja jote e dytë, 9 vite prej se e ka lanë Nexhmedin Arifi, që e përmende, ish kryetarin tonë që e ke realizu këtë projekt, që 9 vite nuk ju ka lëshu uji 2 Sllatinave, Trestenikut. Më fal që nuk e potencova dhe fshatin tëndë Beguncë, domethanë janë këto fshatra të cilat e kanë rrjetin, por nuk është lëshu uji. Ti po thua që mangani ka ekzistuar. Mirë, që 6 muaj nuk ka mangan, por ne kemi kimikale që mundem me largu manganin, por nuk është realizu, këta fshatra janë pa ujë, unë vijë prej Vitisë, jam qytetari i Vitisë edhe te rruga ime pasi që është raporti edhe pyetje edhe përgjigje, po i diskutoj këtu, unë e kam potencu këtu 3 here në seancat e kuvendit, por nuk ke qenë ti asnjëhere. Rruga "Hasan Prishtina" është një nder rrugët më të banushme që unë jetoj aty, beso që në katin e parë të shtëpisë time kam rrymë, nuk është e jotja ajo, por neve na duhet me inicu një trafë aty. Mua më thirin gjithmonë të afërmit që i kam ngat, gjithë lagjia dhe më thonë që, nuk kemi trafë. E kam potencu 3 here me nënkryetarin e komunës, me inicu 1 trafë edhe ujë të pijshëm, ujësji nuk kemi në rrugën tonë. Ti ke thënë gjithmonë që, Vitia është e pastërt, unë po e shof që është e pastërt, por unë edhe në tjerat seanca e kam potencu që, kemi shumë vende të Vitisë turistike. Ne e dimë që tashti është bërë si zonë turistike e Vitisë zona e Letnicës dhe kjo e Dobolldheut për shkak se ka restaurante në 4-5 restaurante që i kemi në Viti i kemi në atë zonë. Tashti po frekuentojnë të gjithë njerëzit e komunave tjera, po vinë te restaurantet që janë në atë pjesë të Letnicës, ju e keni parë që kur të shkojsh në Letnicë ti e ke vizitu para 3 dite, ke qenë atje, e ke pa që është bërë si deponi e berllotut, dhe në rrugën e Dobolldheut kur të kthesh për Buzovik, ti gjithmonë thua se Vitia është e pastërt. Është mirë këto deponitë t'i largomi që për qytetarët ta ketë Vitia një hije ashtu siq e ke prezantu ti. Unë po e shof që disa punë janë kryer, por më së shumti mua që më ra nga të gjitha që i diskutova deri tashti e pashë të gjitha këto projekte të mira që i ke bërë nuk kanë as kosto dhe nuk kanë as punkryes. Neve kjo na intereson kush është punëkryesi, çfarë kosto kanë këto secili, asfaltimi i rrugëve, Sllatinë, asfaltimi i rrugëve rurale, rregullimin e rrethojave të ambullantave vetëm i ke listu, por nuk ka asnjë sqarim tjetër. Kjo më intereson mua, po e themë këtë si partner i kualicionit dhe me ditë qytetarët Faleminderit!

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Nuk ke fol si partner i kualicionit por si opozitë ke fol. Megjithatë je këshilltarë, me respekt të veçant, mos më mëso mua ti se si me fol të lutem, më lejo ta jap përgjegjjen. Përsëri po them, në fillim e the, kostoja, punëkryesi në fund e the, kostoja punëkryesi, se unë i shkruajta. E ki transparente, veç qele kqyre, nuk kam nevojë me ta cek, diçka që e ke publike, që edhe KRPP e ke, qele edhe e shikon. Më fal, por nuk deshta me të qitë keq, por merre kqyre nuk kam nevojë unë atë punë, për shkak që e ke publike. Zona Ekonomike, po është e vërtet që edhe në kohë të Avdullahut, edhe në kohë të Hykmetes. Në kohë të Hykmetes dhe të Avdullahut është nxjerr zona ekonomike, është nënshkru memorandumi për zonën ekonomike, mandej ka ardhë ministri Bajrami i Gjilanit, ka ardhë në kohën që po thua ti, na ka ndihmu në pjesën e dytë na ka ndihmu Bajram Hasani dhe të tjerë, është ndal prej se ka ardhë Rozeta. Nuk jam tu dashtë me akuzu Rozeten unë, se kam folë atë ditë edhe me kryeministrin, kam fol edhe në Pozheran kur ka qenë atë ditë për zonën ekonomike dhe i kam thënë që, me diskutu se kam qëllimin unë me akuzu askënd, por e kam qëllimin vetëm me tregu që ne duhet me ditë të vërteten. Domethënë që nuk është punu, është mirë me vazhdu që ne me bë atë presionin tonë institucional dhe politik, që vërtet me vazhdu, se nuk e kam tjetër kun hallin unë. Palestra sportive, unë a ta dhashë informacionin e saktë çfarë është situata, tashti ne detyrimisht kemi mu detyru edhe për stadium edhe për palestër me anulë dhe me ritenderu, se nuk kemi zgjidhje tjetër pa pagesë, pa rritje të çmimeve ata nuk punojnë dhe kjo është realiteti. Ne me ministrin e kemi diskutu këtë temë, ai ka thënë që unë ja bëjë shtesën, por nuk e ka lëshu me shkrim dhe kemi ngeçë dhe duhet me ritenderu për me hecë. Kur është nisë uji i Begunces nuk kam qenë unë kryetar, ka qenë investimi i ujit të Begunces edhe fabrika përpunuse sllovene, është njëra nder më të mirat. Uji nuk është e vërtet që nuk ka ujë, uji vjen rrjeti brenda për shkak të mungesës. Bëhu më serioz Taulant, merre përgjegjen, mos kesh, unë flasë me krejt njerëzit njëjtë si kryetar komune, institucionalisht, nuk jam tu folë privatisht me ty, privatisht nuk kemi nevojë. E ka marr "Hidromorava" pjesën e mbikëqyrjes të këtyre 5 fshatrave, jo vetëm 5, por edhe 7. Ata e kanë pasë një kalendar edhe rritjen e kapaciteteve të ujit për Kabash dhe Binq, ndërsa edhe Beguncë, Skifteraj, Zhiti e kanë pasë këtë program. Ne jemi tu i mbajtë për fjale që, ata me të vërtet këtë punë me rregullu edhe me i fut orët bashk me "Hidromoravën" dhe me i marrë në mbikëqyrje. Kanë me pasë problematike sikur në Skifteraj brenda fshatit, për shkak të bllokimit, por besoj që e zgjidhin. Tash jemi tu insistu që, vërtet kjo punë me shku përpara. Është një problem për institucionet tona komunale me futë pare e më planifikim tjetër, ku faktikisht ata e kanë obligim ligjor këta dhe për këtë unë nuk kam dashtë me qitë në lajthitje kuvendin me bë tjetër planifikim, me nda buxhet për një punë që ata e kanë obligim ligjor, edhe këtu kam dashtë me u sill në mënyrë të pjekur edhe institucionale. Normal që mua më ka interesu shumë që Beguncen me bë për ujë, për shkak që në aksionin e parë unë vullnetarë i kam hyp atje, me siguri 5 vite nuk është dikush këtu më shumë se unë i interesum për atë ujë dhe do të rregullohet besoj shumë shpejtë, vetëm se nuk kam dashtë me futë në

lajthitje Kuvendin dhe Qeverinë me nda mjete tjera, kur e kanë obligim ligjor. Sllatinat, e thashë unë për 5 fshatrat sa ka qenë analizat e entit higjenik shëndetësor, analizat e ujit. Ne nuk kemi pas guxim me marr përgjegjësin si komunë me i thanë lëshoje ujin, se ka qenë përqindja e manganit. Tashti është zbrit, janë masat e lejshme, ata sigurisht shumë shpejtë do ta lëshojnë, edhe pse Sllatinat kanë pas ujë, por uji për pije jemi tu folë, ajo është për 5 fshatra. Bazeni është në Sodovinë të Qerkezve, edhe përrurimi i bazenit. Ne e dimë që e kemi bërë, por nuk kemi guxu kur ka qenë mangani, edhe tashti është aspekti profesional i cili nuk të lejon me ndërhy. Rruga “Hasan Prishtina” te ti. Drejtorja e Shërbimeve Publike është në funksion në çdo lagje, përshembull problematiken më të madhe e kemi pas në një lagje në Drobesh, këtë problematikë unë nuk e kam ditë për shkak të institucionit privat që është KEDS-i. Ne jemi mundu me kriju lidhje të drejtëpërdrejta me regjion dhe me nivel qendror dhe shkresat e Drejtorisë për Shërbime Publike, në përkrahje të qytetareve, kur kanë mungesë të rrymes ja dergojmë drejtëpërdrejt edhe regjionit edhe nivelit qendror, përveç Zyrës në Viti. Ne jemi në përkrahje të lagjes për rrymë, edhe unë jam bashkë me juve në përkrahje të lagjes për rrymë, nuk është ai problem në çdo kohë edhe jam për me nënshkru letër edhe për me qu letër dhe për me mbajtë takime dhe me bë trysni vetëm një gjë jashtë aspektit politik, se politikisht, partiakisht mundeni me më kritiku, nuk është ai problem. Unë ju thashë, në pika të rendit të ditës kritikohemi nuk është problem hiq. Takimin që kam pas më të rëndin me KEDS-in, kanë qenë aty bashkëpunorët e mi, e dinë se si ka rrjedhë në sallë atje te komuna, për shkak të mos futjes investimeve për Viti për vitet kalendrike afatmesme. E kemi thirr edhe përgjegjësin Izetin, Ramdanin, ka qenë edhe Izeti, mund ta pyesni Izetin se çfarë qëndrime kam mbrojtë unë në interes të qytetarëve aty. Ju keni këtu njerëz që e dinë takimin me “Hidromoravën”, unë çfarë e kam pas edhe çfarë qëndrime mbroj. Sa i përket ujit të pijes, ka me vazhdu këtë konstant dhe kemi me pa rezultatin. Unë nuk e kam njet përtej rezultatit me thanë që kam bërë diçka. Kur t’i lëshojmë 5 fshatra kemi me qenë. E kemi lëshu Germoven, Letnicen, domethanë kemi me qenë transparent për këtë punë. Vitia është e pastërt në raportë me të tjerat, është më e pastra, është më e rivalizime në aspekt të korridoreve, artereve të ujrave sipërfaqësorë. Në krejt Kosovën edhe përroskat i kanë marr, por ne me këtë kalendar që prapë po them nuk është i jemi, por është i krejtë institucioneve, se nuk i marr atributet vetë që i kemi futë në buxhet vazhdimisht kanallet, prrockat, kanalin e Gelbushit, kanalin e Smirës që shkon te poshtë në Drobesh, kanalin e komostacionit, lumin “Letnicë”, “Moravën” që e kemi rregullu, se në një ditë në mëngjes kemi dal e kemi shiku lumin kur ishin të reshurat e shiut. Unë tregoj edhe sahere e kemi bërë pastrimin këto ditë, atyre që kanë qitë përseri është një numër i qytetarëve të pandërgjegjshëm, që e dinë vendin dhe e qojnë rimorkin me traktor. Kjo është çështje që duhet ne bashkarisht me qenë me një fjalë, mbrojtjen kontrollin me forcu në shërbime publike. Në këtë drejtim kemi me punu bashkarisht, unë besoj që kemi me qenë komuna ndër me të pastërta, vetëm duhet mi ndalu këtu sikur që i ndalum te lumi për Binç. E bëmë një rrethojë ose e ndalum te kalaja edhe aty e bëmë një rrethojë përshkak se po e bëjnë jo vetëm deponit e amvisrisë, por po e bëjnë edhe mbeturinat e ngurta, inerte, po i prishin shtëpitë e vjetra apo ku e di unë, po shkojnë po i qesin, që vërtet po e shëmton vendin. Kjo nuk duhet me ndodhë, mbrojtja e kontrolli duhet me funksionu, inspektoriat i ambientit duhet me funksionu, duhet edhe me bë gjoba patjetër, nuk është që nuk ka pas dënime. Disa tema të tjera i keni te pasqyrat financiare, ta keni parasysh këtë, për atë nuk deshta mu ndal te temat e tjera kryesues.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Faleminderit! Nuk do ta zgjas shumë, përveç se Taulantit t’i tregojmë se, ne kemi bisedu për këtë çështje edhe në seancat e kalume. Vetëm deshta me të thënë që, mirë është që edhe bizneset me qenë të kujdesshme në këtë drejtim, mos me hudhë mbeturina, por edhe kompania jote mos me hudhë, kështu që nisu prej kompanisë tënde edhe shko në tjetër.

**z.Taulant Haxhiu:** Kompania ime është shumë e madhe që nuk po e di ndonjë here që ka hudhë dikund që ti gjithmonë po nisesh ne këtë. A bënë ti me më tregu se ku ka hudhë kompania ime?

**z.Basri Aliu, drejtor:** Ner shpinë tande atje.

**z.Taulant Haxhiu:** Ku është, a ki argumente, gjami argumentet.

**z.Basri Aliu, drejtor:** A kam ardh, të njëjtën ditë kam ardh dhe ta kam tërhet vërejtjen dhe prapë po të thamë dhe të kam tregu.

**z.Taulant Haxhiu:** Pas shpisë tënde ki deponi bërllogu, te shpija jote ti nuk ki pastërti, te lagjja jote, e ti drejtori i shërbimeve publike hajde shkojmë te lagjja jote kqyre qysh i ki deponitë, se të kurseva parzit, hajde shkojmë nëse nuk ki deponi të berllogut pas shpisë tënde, je drejtor i shërbimeve publike, unë nuk vi këtu në seancë. Ti po më tregon mua, po më arsyetohesh.

**z.Basri Aliu, drejtor:** Kush je ti që me më tregu për te shpija ime?

**z.Taulant Haxhiu:** Unë të njof, ti je një kshilltarë që i ndërron dikasteret për ditë, kërkushi nuk je. Ti para shtëpisë tënde e ki deponinë e bërllogut, je drejtor i shërbimeve publike.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Jemi tu bisedu për aktivitetet 2022, qeveria e ka për detyrë me i dhanë informatën e punës kuvendit, kuvendi mundet edhe mos me i pranu aktivitetet, edhe mos me u pajtu, është e drejtë, demokraci, ne nuk e kemi njet me folë këtu për shpija e për lagje e për personalizma, ne e kemi në mënyr institucionale me i zgjidh çështjet. Këtu ka edhe të tjerë që nuk janë në qeveri, edhe këshilltarë që kanë ardhë me ndegju debatin, faktet argumentues mbi punën që e kemi bërë në 2022, ka njerëz serioz që vërtet dojnë një debat edhe një kuvend, i cili faktikisht ka qenë shembull, por edhe si komunë raporti edhe pasqyrat financiare që tashti keni me i ndëgju janë më të mirat në historinë e Vitisë prej se egzistojnë. Grumublloni të gjithë ekonomistat regional, nëse ka pas pasqyra ndonjëhere në histori të Vitisë, e keni me 300 euro të barazum që nuk e ka asnjë në Kosovë. Edhe njëhere po ju themë, investimet kapitale 98.52%, 108% të hyrat vetanake, rregullatritet ligjor të plotë, të pranum nga MAPL-ja dhe digasteret qëndror që i monitorojnë kuvendet e komunës dhe monitorues të tjerë, edhe OSBE-ja, dhe me fitim të grandeve, performances. Unë e kam për detyrë me dorëzuar raportin, e keni me shkrim edhe të gjitha nuk e kemi për detyrë me zhvillu replikat, as me drejtu personalizmat dhe lagjet nuk i kemi për detyrë. Këshilltar, nuk jam i interesum me polimizu më shumë, jemi të interesum edhe kuvendin me respektu, unë edhe rivalet politikë të cilët kanë vërejtje parimore në pikë të rendit ditës, qe ku jam unë, ndoshta edhe unë njëmend është hiq, mende dy janë gjysë, tri e përpjet janë në mendje për atë senatet kuvendet, e krejt edhe qeveria që është e gjërë. Ne mundemi mos me pa diçka, ndonjë vërejtje, ndonjë mungesë, ta thotë këshilltari, ta thotë qytetari, për atë është debati me qytetarë, janë edhe organizatat që ta thonë etj, vec në parim duhet me fol. Ne kemi fushëveprimtari politike, partiake, që mundemi me bë kuvendi, nuk është e thamë edhe qeveria me u shndërru në kësi arenë, mundemi në parim me folë, dhe unë po ju tregoj prej përvojës edhe politike, edhe institucionale, se kam qenë edhe drejtor, edhe këshilltar, kam qenë edhe kshilltar në parlament, i komisionit parlamentar, edhe në ministri. Unë po ju tregoj, ai që fol në parim dhe me argumente gjithmonë e fiton besimin e elektoratit më shumë, edhe fiton vota më shumë. Këtë saktë e di 100%, ndonjëhere mundet me fry era, vetëm unë po ju tregoj që, nuk frynë gjithmonë, dhe gjithmonë ai që fol në parim, me argumente, gjithmonë e fiton besimin e elektoratit. Duhet me pranu një informata të një komune, tek e fundit edhe një kryetari që unë nesër nuk jam, është dikush tjetër, dhe një qeveri që nesër nuk është, është dikush tjetër, duhet me pranu një punë e cila është më e mira në Kosovë, që ja pranojnë krejt instancat, me shifra, me argumente. Ato nuk mundet me i mohu askush, edhe me i provu cfardo kundërshtimi nuk mundemi me i mohu argumentet që, pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin 2022 i tregojnë. Prandaj unë e kam paraqitë një informatë, për atë e kam paraqitë dokumentarin. Unë pashë që dikush e quajke film, dikush hajgare, por nuk është muzikë, është dokumentar transparent, llogaridhënie, të tregon, të kthen me pa që është ndreq rruga për Sllatinë, është ndreq për Mjak, për Stubëll tu punu, e mandej të tjerat. K dobësi, por mos harroni, pjesa politike dhe kuvendi nuk i kqyrë krejt, por është aspekti janë të rregullume normat edhe instancat, edhe ata që merren edhe me devijime edhe me lëshime me problematike, janë të caktum.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit kryetar! Megjithë pjesën e këtij debati, që me të vërtet nuk guxojmë me ngritë gishte, ti fjala, ti këtu, nuk guxon me ndodhë, se është e keqe, sepse këtu nuk jemi për ti, ne jemi pak më gjanë, askush nuk është unë, askush nuk është personalitet në veti, por është që përfaqson qytetarët, përfaqson një pjesë të votës, janë gjerat më të përgjithshme, nuk guxojmë me folë në veten e vetë, se në momentin që jemi këtu, jemi përfaqësues dhe përfaqsojmë interesa, përfaqsojmë probleme, jemi njerëz, nganjëherë mund të ketë ndonjë eskalim ndonjë moment, por megjithantë ju kisha lut, ju kisha kërku çështje të përgjithshme, çështje të interesit të vendit, çështje te raportit të përgjithshëm. Mund të diskutojmë se, asnjë gjë nuk është personale, asnjë punë nuk është personale, as e kryeatrit, as e imja, as e juaja, por jena gjëra të përgjithshme që mundohemi me i bë më mirë. Në këtë aspekt ju kisha lutë me e drejtu debatin. Faleminderit!

**z.Nexhat Halili:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë një koment të vogël, për pasqyrat financiare do të flasim pak më vonë, do t'i argumentojmë. Unë i kam 2-3 pyetje kështu si fillim për kryetarin, megjithë premtimet se prej seancës së 3-të, gati për qdo seancë është ngritë kjo çështja, e trotuarit që lidh 3 fshatrat, Trestenikin, Sllatinën, Sodovinën ende nuk ka asnjë hapë në seancën e 3-të. Kryetari i Komunës ka premtu se, dikund ka seanca e 5-të do të fillohet puna dhe do të më ftoni për fillimin e punës së trotuarit. E kam një pyetje, se kjo është një rrugë shumë e vogël, por është shumë kohë e gjatë që nuk po kryhet, rruga "Ali Muhaxheri", e cila është me një distancë diku 900 metra. Kanë hy në procedurat e prokurimit, por nuk e di pse nuk po fillohet puna e kësaj rruge. Kryetar, prej fshatit kam edhe unë një kërkesë, sikurse pat Taulanti, për trafo. Janë 3-4 lagje që e kanë rrymën aq dobët saqë nuk po hy më detalisht, po e kuptoni tashtë. Për ujesjellësin premtove se në seancën tjetër, besoj që "Hidromorava" do ta merr në menaxhim, nëse e merr "Hidromorava" të përgëzoj. Tash po flasim për informatat të cilat i ke ofru kryetar. Te Njësia e Auditimit të Brendshëm, në bazë të planit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka parapa që t'i bëjë 4 auditime, mirëpo nuk ka arritë të realizoj planin, për shkak se ka arritë t'i realizoj vetëm 3 auditime. Zyrën e Prokurimit, tatimin

në pronë, dhe procedurat e menaxhimit shpenzimet për mallra, shpenzime dhe punë për vitin 2021. Kryetar, ku është problemi që nuk ka, sidomos kryetar këtu me rregulloren cdo komunë ose autoritet kontraktues, mbi 7 milion të cilët i kanë buxhetin, parashihet t'i kenë ka 3 auditor në zyre. Për momentin kemi vetëm 1 auditor. Cka është problemi? Se dikund ka Marsi apo Prilli, vitin e kalum, personi i cili ka qenë drejtor ka dalë në pension, personi tjetër tashtë është drejtor, keni mbetë vec me drejtor të auditimit: cka është puna këtu? Jeni duke certifiku ndonjë person të juajin, që në të ardhmen ta punësoni. Në bazë të këtij raporti të auditimit, unë po shof që këtu në informatat ti që i ke pru në Kuvend shofë që ka mangësi, askund Njësia e Auditimit të Brenshëm nuk ka dhanë një opinion së paku në këtu nuk po shohim një opinion. A e ka dhanë opinionin kalues apo nuk e ka dhënë? Te Zyra e Prokurimit ku auditori ka bërë auditim, as për këtë zyre nuk ka dhënë kurrfarë informate, nuk po shof që ka informata këtu edhe pse tashti më vonë është te Zyra e Prokurimit, ku e ka paraqitë raportin e vetë, mirëpo kjo është te Zyra e Auditimit, të njëjtën e kem për tatimin në pronë dhe të njëjtën e ki për pikën tjetër. Zyra e Prokurimit në këtë raport të paraqitur nga kryetari i komunës për Zyrën e Prokurimit, vërehet se gjatë vitit 2022 Zyra e Prokurimit ka njësuar 68 procedura të prokurimit, 30 landë furnizime, 21 lëndë shërbime, 17 landë. Punë në këtë informatë shof se kemi potencuar se, nuk po shofë se në këtë dokumentacion është cek se është përgadit planifikimi i prokurimit, unë nuk po shof se keni përgatit këtë planifikim, se sa janë vlerat e alokuara, po flasë sipas prokurimit, jo sipas këtu, se sipas pasqyrave financiare do të flasin në pikën tjetër. Sa aktivitete janë nënshkru kontrata, sa është diferenca në mes alukimit dhe shpenzimeve, cilat janë aktivitetet e anuluar, cilat janë procedurat e negociuar pa publikim, njoftimit, kontratës dhe pse është përdor procedura e negociume pa publikim të njoftimit të kontratës. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, edhe unë i kam vërejtjet sikur kolegia më herët. E kuptoj që mund të ndodhë që prej 01.01.2022 deri me 31.12.2022 mundet web faqja e komunës mos me funksionu, po të paktën mundet mos me funksioni 1 muaj 2, nëse ka probleme, por muajt tjerë ka funksionu unë e shof që publikimet tjera bëhen, njoftimet për dhënie të kontratës, bëhen kontratat e prokurimit, nuk publikohen, por cka është më e rëndësishme kur publikohen në prokurimit elektronik, kontratat nuk publikohet edhe përshkrimi i cmimeve të operatorit ekonomik fitues në prokurimin elektronik, pak më herët e potencove prokurimin elektronik. Tek Drejtoria e Financave, drejtorë, këtu paraqitje e pasqyrave vjetore, faqe 17 unë e kam, por ti nuk e di tashti Janar-Dhjetor 2021, është ndonjë gabim. Unë i kam dy faqe, kështu më del ndryshe. Tek sektori i tatimit në pronë shkalla e realizimit sapo e shof unë është 82.5%, në pasqyrat financiare të paraqitura për 3-mujorin e parë të 2 edhe 3, gjithmonë shkalla e inkasimit ka qenë mbi 100%, cka është tashti, ku ka ngeçë që ka ra 82.50%. Kryetari e potencoj rritjen e cmimit për operatorët ekonomik dhe e barti barrën në nivelin qëndor. Kryetar, është e vërtet që ka ngritje të çmimeve, edhe qeveria ka marrë një vendim për cmimet e artikujve, bazë edhe artikujve tjerë, mirëpo tashti ku është problemi nuk e di, mirëpo kjo juve nuk ju ka pengu, arsyja është dikund tjetër. Në rrugën Sllatinë-Viti, në vitin 2021 keni lidhë kontratën me vlerë 224 mi e 667 euro e 20 centë, diku në muajin e 10 nuk ka fillu. Puna e kësaj kontrate është pritë deri në Korrik të vitit 2022, është lidhë kontrata tjetër me të njëjtin operatorë ekonomik në vlerë 544 mijë e 251.89 euro, që domethanë edhe kjo juve nuk ju ka pengu, keni mujtë t'i kryeni punët. Tashti këtu shof te Drejtoria e Financave, Ekonomi dhe Zhvillim, thotë se realizmi i planit vjetor është 113.27%. Sipas pasqyrave është pak më ndryshe, është 119.79%, është lëshu ndonjë gabim teknik, tashti këtu i keni paraqitë. E keni akuzu organin shqyrtues të prokurimit publik që, nuk ka funksionu, por kjo nuk ju ka pengu o z.kryetar, rrugen Viti-Kerbliq e keni nënshkru edhe pa aprovim të organit shqyrtues të prokurimit publik. Faleminderit!

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Nexhat, ekonomist je, por je edhe jurist këtë mos e harro, po ta themë për herë të parë edhe në faktë unë jam agronom, por nuk jam edhe jurist, kam Zyre Ligjore, kur kish kësi adresime i drejtoresh Zyrës Ligjore e merr interpretimin ligjor, nëse interpretimi ligjor edhe i MAPL-së edhe i Zyrës Ligjore të komunës është negativ në raport, ne mundemi me fol për këtë temë. Unë jam agronom, por unë konsultohem me Zyrën Ligjore, jo vetëm unë, secili drejtorë, përveq obligimit ligjorë me respektu rregullaritetin ligjorë, unë për cdo vit bëj vendim, merre vendimin. Unë e kam shpërnda cdo drejtor, cdo zyre për rregullaritet ligjor, se kam kujdes në këtë punë. Prandaj ndesh edhe ta shpjegoj për shkak përvojës menaxheriale, kur kalon 45 apo 30 ditëshi si është i përcaktuar me ligj, heshtja administrative hynë në funksion. Rruga e Sllatinës, ritenderimi edhe këtu, shikoje ligjin nëse kompania nuk pajtohet me ritenderu me dhënë, ti nuk ke të drejtë me qitë në ritenderim, nëse pajtohet për stadium edhe për palestër, ti mundesh me qitë në ritenderim, ai duhet me dhanë me shkrim, është ligji i përcaktum që ti përcakton kornizat, ma mir është kanë me kry stadiumin, palestrën e të gjitha edhe unë jam për ritenderim edhe të saj, edhe të saj, sepse ministria faktikisht nuk e ka kry obligimin e vet që ma ka dhanë betimin, zotimin në sallë në prezencë të gjithëve. Neve na nevojitet me u kry punë, po e mbron një dicka që nuk është në interes të qytetarëve, unë jam duke e mbrojtë interesin e qytetarëve, këtu është dallimi. Prokurimi publik disa here po e thu, nuk ka qasje zyrtare që keni kërku deri tani, i kam shënimet e që nuk ja u kam dhënë, kërko qasje zyrtare e merrë informacionin

Nexhat. Web faqja është faji te niveli qëndror, OSHP-ja janë fajet e nivelit qendror, OSHP-ja i ka ndal komunat mos me i kry implementin e projekcionin, investimet kapitale, nëse ti si ekonomistë këtë e mbronë ndryshe je gabim shumë. OSHP edhe qëllimisht se kanë konstitu OSHP-në, me i ndal projektet, mos me implementu. Faji e adresimi është në qeveri. Rrugën e Mjakut e ka ndalë qeveria, Hysen Dermishi e ka ndalë, në këtë qëndrim duhet me mbrojtë krejt, e ka ndalë për shkaqe politike, por nuk ka mujtë më shumë se ligji nuk e ka leju më shumë, se ish sanksionu, e kemi procedu landën. Zyra e Prokurimit është e vërtet që jemi me 1, ne nuk kemi nevojë me mshef atë, por ne kemi kërku me na u leju në buxhet, auditor tjetër me na e qitë. Edhe te arsimit jemi tu pasë problem, po shkon mësuesi po ti lenë nxënstit se na ka ardhë 223 me zvoglu numrin. Pse i kemi bërë Nexhat pasqyrat dhe informatën bashkë, se për këtë nuk e nija asnjë kshilltarë, përveq Alis: “kryetar, faleminderit me qeverinë që seancën e parë të kuvendin për këtë vit edhe pasqyrat edhe informatën”. Mirëpo ju themë, asnjë kryeatr komune në Kosovë në seancën e parë nuk i dërgon reportin e punës edhe pasqyrat, kam dashtë performacë dhe kam dashtë me qenë obligativ edhe me qenë i përgjegjshëm me qenë me juve dhe i kqyr me i nda, asnjë nuk e dëgjova dhe mua po më dhëmë më së shumti kur nuk po e pranoni defektet që po na bënë indibicioni nga niveli qendror. Mbrone bllokimin e OSHP-së, mbrone bllokimin e web-faqes, mbrone bllokimin e memorandumeve, mbrone bllokimin e rrugës së Mjakut për 1 vitë e gjysmë pa asnjë arsye hiq, dhe ti po më thua që është ligjore nënshkrimin e kryetarit me prish dhe me nënshkru me zv.ministrin. Këtë e ka bërë, mbroje, nuk jam duke të ndal. Jakup, unë ju dëgjova te mbrojtja, por edhe ty si shef i grupit parlamentar, por tashti ky bëri pyetje më shumë se grupi parlamentar. KPF po diskutojnë, e japin mendimin grupet parlamentare, aty janë përfaqsesit e të gjitha partive, tashti ne vetë po i zgjasim diskutimet se, kur të folë shefi i grupit parlamentar i paraqet 20 pika, ju përgjigja, kurse ti 21 plus të pasqyrës financiare që i ki atje, unë nuk kam faj po të përgjigja, se mos me ju përgjegj kryetari nuk po përgjegjet. Një gjë po ta themë, se cka të them unë 100% është ashtu. Unë jam argumentues, trotuari as nuk e ndreq ti as nuk e ke planifiku, e kam planifiku unë edhe e ndreqi unë, e kam premtu unë, e kam shti në buxhet unë, ka me ndreq unë e jo ti. Ti je tu dashtë me marrë vec merita, popullësisë me ju arsyetu, votës që ta kanë dhanë, për atë hajde me mu kur ta nisim, ndreqet moti, merrni ato poena, por një gjë pranoje, trotuari është i buxhetum. Për këtë arsye e thirra edhe inxhinierin, aty mbrapa e ke, me qu me të drejtë unë duhet me liru veten nga kjo situatë me polimizu Nexhat me ty, përshembull kur i ki faktet. Edhe për Smirë, 13 projektet që i kemi projektu, qe ku është inxhinieri ti tregon me kod që janë të buxhetume jashta planifikimit që sivjet kemi me bë sërish, i cili ka me qenë në kalendar 2023-2024 trotuari në Sllatinë, te Qostë, Trestenikë është në veti, trotuari Sodovinë e Qerkezve, Sodovinë e Jerlive është në vete. Informatën e kryetarit jeni duke përzi. Në informatën e kryetarit ti bënë pyetje, unë të përgjigjem cka di, cka nuk mundem ta bijë në seancën e ardashme. Ti edhe po krijon opinione, po më tregon edhe po më pyet. Nuk ki cka me më tregu se, unë e di më mirë se ti, se e kam planifiku, e kam memorien e zhvillume shumë, nuk harrojë asgjë. Trotuari është i planifikum Sllatinë - Trestenik te shkolla dhe është tjetrin te fabrika “Vala”, del te stadiumi në Sodovë të Jerilive, ai është projektë i buxhetum, nuk ka lidhje me projektin 2022 që e kemi mirtu tashtë në 2023 që implementohet, ai fillon është i buxhetum. E ki edhe rrugen “Ali Muhaxheri” 601 meter i ka krejt, 300 i kam shtru, 301 meter janë të planifikum me u kry. Rruga “Ali Muhaxheri” i bie te zabeli në anë të majtë, atë rrugë për Komogllavë e kam ndreq, dy rrugët, Trestenikun e kam lidhë për Komogllavë dhe jam duke e planifiku rrugën tjetër që e lidhë Sodovinën e Qerkezve me Trestenikë, por për atë me kryetarin e fshatit ki me ardhë atje si kshilltarë e bëjmë bashkë edhe merri poenat politikë nuk e ke atë problem problemin e ki me i pranu faktet me pranu realitetin e punës të madhe që është punu historikisht dhe pasqyrat më të mira se unë po e lidhi me pasqyrat Nexhat ti e dinë në qfarë kondita bazohet pasqyra 300 euro e ki plus minus kurr nuk e ke pasë në histori të Vitisë pasqyrat ne mundemi me qenë kundershtarë qfare do por realitetin duhet me pranu shqiptari suksesin nuk po e pranoni, ti je në mesin e 5 komunave ti hin shembull je në mesin e komunave të para që të thirrin për praktika të mira atje ligjoron ti i fiton krejtë grandet, ti përshebull i ki 98.52% investimet kapitale edhe kqyre qfarë debati kemi zhvillu sotë nuk është faji jem se unë jam shumë kolegial dhe bashkëpunues përbesë a ju thashë kshilltarë urdhëroni edhe për lokalitete e juaja ku keni votë urdhëroni në zyre të gjithë pa përjashtim e jona është me rendesi që në të gjitha vendet që ka nevojë me punu, unë kam ardhë me projekcion edhe unë e marrë për bazë edhe projekcionin e juaj por të folim në mënyr argumentuese profesionale këtë e kemi pasë projekcion e marrim dhe e qojmë përpara, unë po themë edhe një here për vitin 2022 nuk jam duke folë politikishtë është më i suksesshmi i Vitisë në histori, viti 2023 nëse bashkëpunojmë ja kalonë e kam fjalën në bugjet në projekcione në projekte të mira, psh projektin që kemi kodu për Sllakovc Ramjan projektin që lidhë Sllatinat edhe te Llulect edhe që i lidhë te Korrant me Pozheran projektet që i kemi shtigjet e biciklsteve në Pozheran që i lidhem me Viti projektet që i lidhim te pumpa te Begraca që dalim në rrugë se juve ju dokë që vetëm fola jo se në Sodovinën e qerkezve unë e kam pru atje te vorezat e dini ju rrugen ndërsa tjeteren e kemi kodu me pru te varrezat e Sllatines poshtme rrugen e nismi atje kjo del te rruga e Smires që lidhë Germoven Drobeshin e lidhë rrugen me Sllatinë kjo lidhet e Samakoves lidhet e Mjakut lidhet e Kodres Furrres

e alternativa lidhet Godeni edhe lidhet e Stanqiqit këto tonat janë të krejtve edhe lidhet rruga Novosell në asfalt që e lidhë edhe Terpezen me Qifllak edhe e lidhë te Alidemtë dhe projektet e tjera, inkupadori ka me qenë mega projektë të tjera sfida që i përmenda ndihmonem edhe ju masi jeni në qeverisje unë kur kam qenë në qeverisje e kam nënshkru memorandumin edhe për palestër për stadium për zonën ekonomike të tjerët kanë ndihmu hajde ndihmoni edhe ju, unë po them që asnjë projektë të rijë nuk na kanë dhanë fakt jam tu tregu atë qka ja thashë edhe kryeministrit në grandë, për Gerlicë nuk jam tu folë prej mendjes së madhe veq ne ta nisim jam tu folë prej frikës që nuk po du me gjujtë karrota neve veq hajt se me 2 milion nuk ndreqet Gerlica 1 kam të urës nuk mundesh me ndreq ka Varoshi, unë edhe atë here kam thanë janë deklaratat televizive Gerlica 8 deri 11 milion jo 52 milion qysh e kanë rritë me ato të Babushit dhe mbikalimit në Elez han por jo me 2 milion dhe unë jam skeptik si të ndreqet unë ja japë dorën dalim bashkë e urojmë, Nexhat pse e ka shti rruget e Mjakut ish ministri Abrashi e ka nënshkru shiritn ka me pre ministri i tanishëm qka ka me pengu, atë ditë unë e kam thirrë zv.ministrin ai ka ardhë 1 ditë mbrapa, rruget për Gjilan që ka dalë ai atë ditë unë me Avdullah Hotin me kryeministrit në Kllokot e kam nisë atë rrugë ju e dini mirë, ju po e kritikoni rruget e Sllatines shkoni kqyrne rruget e Gilanit qysh është te kry pranoni gjërat reali qysh janë.

**z.Musli Neziri:** Para se me fillu, kështu si ja këna nis me zgjatë, laptopët që i kemi, meniher me na bë një zgjidhje nga aspekti i mbushjes së baterive, se bateritë vec fillun thuajse me e leshu. Kur është bërë për me na ardhë laptopët u dashtë me mëndu edhe këtë, në sallë me pas mbushësa. Kryetar, e pamë gjithë elaburimin e punës. Unë isha ndal në disa pyetje konkrete, pa dashtë me hy në debate, nuk po më pëlqen mënyra si ka shku deri tashti, mu personalisht. Po dua me të pyet kryetar, te pjesa e shëndetësisë, meqenëse është edhe drejtoresha e shëndetësisë këtu, prej 9 ambulantave që janë këtu, që janë cekë si ambulanta të Mjekësisë Familjare, vetëm Zhitia jofunksionale, prandaj po dua me pyet, ata banorë kur do të mund me u funksionalizu ambulanta, e dimë që janë punu disa punë te rrethojat dhe është pastru terreni i ambulantave, i oborrit, por ajo ende nuk po funksionon. A pritët që këtë vitë ajo mu funksionalizu? Qoftë kryetari, qoftë drejtoresha, besojë që munden me dhanë informatën. Kryetar, javën e kaluar ke pas një takim me drejtorin e Agjensisë për Menaxhimin e Emergjencave, dhe konkretisht e kam pa, e kam lexu edhe statusin në faqe të komunës, që është për objektin e zjarrfikësve. A ka dicka konkrete rreth saj? E dimë që është stergjatë shumë, prandaj a janë zotu ose ta dajm kompetencat, ta dimë se kush është përgjegjisi që të kryhet ajo, kaniher mos ta hudhim fajin herë anej herë anej, se po e shohin se qe 3 orë është debati, shpeshëhere atë të cilën po dojnë me marrë atë që nuk po dojnë, po e hedhin tjetër kun, prandaj domethanë është kriju njëfar, u bë trendë kjo në politiken tonë, e që për fat të keq qytetarët po psojnë. E kam pas edhe si pyetje me të bë, te pjesa e dy Sodovinave që i lidhë trotuari, e thatë, besojë që është e mjaftueshme edhe për ata qytetarë të cilët janë të interesum. E dimë që është projektu buxheti, është nda buxheti, prandaj vec kam pas me të pyet: pse nuk kanë fillu punimet, nëse atë u zotove që do të fillojnë punimet? Kështu që, ajo do të kryhet shpresoj, por një pyetje, meqenëse jashtë rendit të ditës kam pasë me bë, tu e ditë që jemi në sezonën e dimrit dhe konsumi i energjisë elektrike është rritë e dimë të gjithë, te shkolla ose institucioni i arsimit dhe aftësimin profesional që po e quajmë tashti, ne ja ndërrum emrin shkollës së mesme profesionale "Jonuz Zejnullahu", është ka përsëritet vazhdimisht një problem me mungesë të energjisë elektrike në shkollë, dhe së fundi here jemi ballafaqu para 10 dite, besojë që je i informuarë tu e pasë parasyshë që, aty ai institucion i arsimit, meqenëse është edhe në qendër, tanimë me fillimin e gjysemvjetorit të dytë parashihet që me u bë disa ndryshime, përshtak të renovimit që do të ndodhë në gjimnazë edhe këtë informatë e ke kryetar, je tu punu në këtë drejtim, por aty tanimë konsumi i energjisë elektrike nuk po mjafton, sepse institucioni është lidhë në rrjetin elektrik, inxhinierët elektrik e dinë këtë pjesë, është lidh si konsumator i thjeshtë, prandaj para 10 dite aty kemi pas problem dhe është me nifar forme është kërku që me u rujt ose me u kursy energjia elektrike aty, për shkak se disa aparatura që janë në shkollë aty, thuajse vec janë jashtë funksionit, jashtë përdorimit. Kryetar, besoj që e ki informatën e dorës parë, sepse edhe shoqja juaj punon aty, pikerisht tek kabineti i teknologjisë ushqimore, aty tashti veq se kanë fillu me kalu me këtë pjesën, kanë dhanë besa furnizimin me boca të gazit, që me mujtë me punu, prandaj aty kryetar duhet të bëhet një trafo e re. Zgjidhja është për me u bë një trafo e re, nuk po hym asaj që i takon KEK-ut, por ajo nëse nxjerret KEK-u, e dimë që është një kompani private, aty mundet me u bë kryetarë me një buxhet me dalë një trafo e re edhe mesa e dimë edhe inxhinierat elektrik të komunës ose kushdo, që është bërë pranimi i shkollës në 2015, kur është bërë porurimi i shkollës, edhe atëhere nuk i ka plotësu kushtet kyqja në rrjetin elektrik, prandaj zgjidhja e vetme kryetar është që të bëhet një trafo e re, trafo e re që do të finanohet nga komuna normalisht, sepse KEK-u, ata jan një firmë private, me rëndësi aty për me u bë zgjidhja e këtij institucioni afatgjatë po mendojm, se jo sikurse që na ka ndodhë, që shpeshëhere ka ndodhë që janë kallë krejt përquesit dhe ka ndiku ajo që edhe lagjet kanë mbet. E dimë atë për fatë të keq ka ndodhë edhe zjarrfiksit kanë intervenu, prandaj këtë e pata si shqetësim, meqenëse jam edhe punëtor i atij institucioni arsimor. Faleminderit!

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Këshilltarë, se drejtoresha e shëndetësisë nuk qenka këtu. Tendenca ime është me funksionalizu edhe ambulaten e Zhitisë, kapacitetet profesionale nuk i dijë, por kemi me u mundu me i shtu, me funksionalizu, për atë kemi punu edhe në pastrim, në rivitalizim, në mënyrë që, ato fshatra, Zhitinë dhe Ballancen t'i shërben. Është e vërtet, ki të drejtë plotsishtë, prandaj ka me qenë tendenca, bashkë kemi me kqyr me drejtoreshën, me QKMF-në edhe me juve, me kshillat e fshatrave. Të dytë me funksionalizu, unë jam për me funksionalizu. Ka kërkesa për ambulanta të reja, Radivojci po e kërkon, e të tjera. Ne jemi tu kqyrë edhe në këtë drejtim. Takimi me AMEAN është pyetja më e mirë që e bëre, se edhe unë harrova me përmend, njëra prej problematikave që kemi pasë te objekti i ndërtesës së zjarrfikseve, e kemi pasë sfidë, por kemi fillu me tejkalu. Me tregu të drejtën tu ju falenderu drejtorit Basri, se Basria i ka mbajtur takimet, i ka qu përpara edhe në këtë gjendje shendetsore, që ka qenë qfarë ka qenë e ka qu përpara me AMEAN këtë punë dhe ma ka siguru takimin final. Unë besoj që parafinal ka qenë se final kemi me nënshkru memorandum, ku ne bashkëparticipojmë, kam pajtu për shkak se kemi kodin e bashkparticipimit, por patjetër e kam edhe e kryem, e finalizojmë këtë objekt, edhe Verës shpresojë në Qershor para zjarreve, dashtë Zoti mos me pas, por ka me pas, se gjithmonë pjesa emergjente është kështu. Edhe ne mu disluku aty, ashtu jemi dekordu, por shumë shpejtë e shohim memorandum. Te shkolla e mesme profesionale nuk jam kanë në rrjedhë për energji shumë, për ato tjerat jamë në rrjedhë, se te ky aspekti tjetër që po tentojmë me disloku shkollën “Kuvendi i Lezhës”, te shkolla profesionale dhe te “Dëshmorët e Kombit”, për shkak të dinamikës së punës, se ti e qele një temë që është sukses dhe rezultat i vitit të kaluar, që kemi punu me IPA treshin, qe 2 vite jemi tu punu, faktikisht rivitalizimin e tërësishëm të shkollës “Kuvendi i Lezhës”, e kemi fitu faktikisht është një grandë i jashtëzakonshëm. Unë kam mbajtur takim edhe të Shtunën me ta, unë e kam dhanë një sulucion tjetër oregjinal timin, që kam pas si kryetar, ja u kam dhanë edhe bashkëpunotëve të mi atë ditë në takim me inxhinierat mbikëqyrës të Prishtinës, e kam fjalën që e perfaqsojnë projektin e IPAtreshit, Unë ju kam thënë që, ju disloku fillimin e punimeve nga 27 Shkurti kur e kemi pas afatin me disloku në Qershor, ndërsa në qershor ne i fillojmë pushimet e veres, e kemi një plan dinamik, dinamikë me shtu 3 muj ditë, tani në Shtator unë shpresoj që krijohet hapësirë për dislokimin e anës operacionale tenike bankave karrikave te shkolla e mesme profesionale e vjetër përshkak se sallën e rregullojmë ajo ka qenë shumë e logjikshme plani dinamikë në shtatorë na jepë neve mundësi faktikisht me i disloku edhe me ju liru juve që mos me i pengu, 3 shkolla në këtë rast i pengojshim, 3 shkolla. Për me i ik kësaj shtate, unë e kam dhanë këtë sulucion edhe besoj që janë pajtu të gjithë, që ne me i ik në këtë formë, kemi mundësitë kemi me pa, por nëse kemi ndonjë vështirësi e tejkalojmë bashkë, për shkak se 39 klasë me 800 nxënës, nuk mujshëm me i apsorvu krejt te shkolla. Besoj profesorë që pajtohesh me këtë se, edhe u pengojke shkolla “Kuvendi i Lezhës”, edhe shkolla mesme. Unë i thash drejtorit për cështjen e trafos me diskutu me KEK-un edhe për atë të Taulantit, për atë lagje. E kemi edhe një lagje në Drobesh edhe një lagje “Delia”.

**z.Musli Neziri:** Pjesa e rrymës te shkolla jonë, besoj që është interes i të gjithëve, sepse tani më shkolla profesionale ka fitu edhe projekte të tjera, tashtë është në implementim, ku do bëhet digjitalizi me Wi-fi me një pjesë kogjo të mirë të pajisjeve elektronike, prandaj rrjeti elektrik ka ndodhë që shpeshëhere me na qitë sistemin e IT-së prej punës. Prandaj po kërkoj që zgjidhja më e mirë e mundshme është ajo trafo.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Ti je tu diskutu për shkollë që na takon të gjithëve. Ne kemi me bisedu me drejtorin regional, se e shtynë më shumë edhe me drejtorat e nivelit qendror të KEDS-it, e shterrim që mos me i hargju paret prej komunës, se në të fundit ne duhet patjetër me marrë vendim në kuvend se nuk kemi drejtë ndryshe me bartë buxhetin, por na u vonohet pak edhe na kushton nëse mundemi me nxjerr është më mirë. Edhe te tjetra, jam dakord tek programi me gjerman, që ka me fillu, ajo është e jashtëzakonshme. Te shkolla profesionale, por në të njëjtën kohë po fillojmë me këtë investim me gjermanët te shkolla e mesme profesionale. Në anën tjetër me IPAtreshin, dhe dikush po thotë nuk ka investime, palestra sportive etj. Këtu po harrojnë këshilltarët se, vetë e kanë qu gishtin, i kanë votu disa projekte me propozimin e qeverisë, e kemi bërë bashkë. Na dy palestra shkollore sportive në Sllatinë dhe te “Kuvendi i Lezhës”, i kemi projektin këtë vit. Në këtë vit kanë me fillu, plus jemi me 6 projekte nëpër shkolla, fushat e gomës që i pat te shkollat, p.sh.: këshilltarja e Lubishtës, ajo fusha gumës te shkolla me tribuna, me krejtë ne e dimë se si u kanë gjendja nëpër të gjitha. Më herët 3 palestra janë, palestrat e vjetra kemi me i dhanë një destinim tjetër, kemi me bashkëbisedu, e kam një ide të shkëlqyshme që na banë nderë krejtve. Ne kemi mundësi shumë, se tashti kemi fitu objekt të jashtëzakonshëm, plus kemi kriju kushte për kabinete. Kabineti i maqinerisë, takstilit, teknologjisë ushqimore, qendra e karrierës, qendra e aftësimi profesional, për bujqësi, Zyra e Investimeve, pjekurinave, melmesave, konservansat, shkollën e muzikës mundemi me bërë, të mjekësisë me 4 paralele, sallën e teatrit në “Kuvend të Lezhës”. Aty kanë me qenë dhe kanë me pas hyrjen secili vec. Kabinetet e juve kanë me pas hyrjen direkt, 4 hyrje janë aty. Unë i kam analizu me inxhinera.

**z.Illir Zuka:** Unë vetëm deshta me faleminderu kryetarin për punët e mira që janë bërë, tu llogaritë që 3-4 muaj të vitit 2022 kemi qenë të bllokuar prej OSHP-së, domethanë prej ankesave firmave kontraktuese që kanë konkuru në tenderim dhe që kanë bërë ankesa në OSHP, dhe e dimë që për muajin Janar, Shkurt, Mars, Prill nuk ka qenë komisioni i formuar i OSHP-së, kanë mbetë shumë tendera të pezullum, tu llogaritë atë. Unë po besoj që është bërë një punë shumë e mirë, është e drejtë e cdo asamblisti me ngritë pyetje, shqetësime, sepse qytetarët na kanë dhanë atë të drejtë, edhe pse jam pjesë e pozitës, unë e dini që jam një nder ata që kam ngritë më së shumti pyetje në të mirë të qytetarëve, tu ja nis shkollës, stadiumit, e të tjera. Unë e kisha një lutje, këtë vit kisha lutë që ne të kemi pak më shumë bashkëpunim mes veti, si ekzekutivi, si legjislativi, këto punët e mëdha, tu ja nis prej shkollës së Pozheranit, stadiumit, palestrës, qendrës së zjarrfiksave, bashkpunojmë t'i përfundojmë se janë në të mirë të qytetarëve. Nuk po përfitojmë asgjë prej këtyre debateve që po i bëjmë, edhe po mbyllet seanca dhe nuk po bëhet asnjë punë. Po më duket që po dojmë me dalë kishe unë po foli më shumë e jo më pak.

**z.Durim Sylejmani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë do të doja në fillim të lidhesha me debatin i cili u zhvillua deri më tashë, kështu, po mendojë që për zonën ekonomike, shkollën në Pozheran, kyqjen në Gerlicë, palestren Drobesh, kryetarit duhet me i ardhë marre dhe turp me fol më për këto punë. Ka dalë në fushatë zgjedhore dhe i ka rrejtë edhe pleqt me kapuq të bardhë, tu ju thanë votonem se unë ka me kry këtë punë dhe nuk e ka kry kurr, tash e 9 vite dhe nuk ka me kry. Ndërsa sa i përket raportit të punës së kryetarit, është i njëjti raport gati si cdo vit tjetër, përkundër asaj që këtu ju thur lavdata. Do të përmbledh në pika të shkurta, i gjithë potenciali i komunës është i angazhuar edhe i orientuar në infrastrukturë rrugore, politizimin e arsimit, administratën e tenderomoninë, asfalti i t'holluar, trotuari i shtruar me asfalt si askund tjetër në Kosovë, janë dëshmi e kësaj qeverisje të Sokol Halitit. 9 vite në qeverisje ende nuk kemi ujë të pijes, gypat e rrjetit të ujit janë lanë rrugëve në lloqë anembanë fshatrave të Komunës së Vitisë, si dëshmi i kësaj është fshati Verban, ku përkunder që nuk ka ujë, komuna ka kontraktuarë një kompani për të bërë kyqje në gypa, mbi 100 shtëpi janë kyqur në sistem pa ndonjë fletpagesë nga kompania, e pa ujë tashtë e sa vite. Po ashtu po e njëjta gjendje është edhe me kanalizimin, i cili është lënë pas dore, i cili po kundermon si qeverisja juaj. 9 vite qeverisje 9 vite degradim e shkatërrim i qytetit të Komunës së Vitisë. Kryetari she gjithcka mirë, përkundër që është keq. Qyteti i Vitisë është i degradum nga ndërtime pa leje e pa asnjë kriter, shkaku i mos planifikimit urbanistik e hapsinorë nga komuna. Ky mos planifikim i ka sjellë dobi më së shumti kryetarit, e për këtë e dinë ai vetë, prandaj i mbanë syt e mbyllur karshi kësaj dukurie, sikurse këto ndërtime të bëheshin në Vernez a në Vernakollë, ku nuk kemi qasje për cdo ditë e leje më kur Vitia takohen cdo ditë këtu edhe shihen. 9 vite politizim i arsimit e administratës, ku kushti kryesor për të qenë i denjë për punë nuk është diploma, dija, por njoftsia e shoqnia, 9 vite dështim, regres e humbje. Kjo është storia e Sokol Halitit më e mira. Në këtë raportë nuk e pashë edhe një punë të cilën e ka bërë kryetari, atë të ndërrimit të nënshkrimit. Kryetar, pse e ke ndërru nënshkrimin. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit Durim. Vetëm së paku edhe më herët thashë, në çështje të fjalorit duhet me pasë kujdes. Faleminderit!

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** I mjer je vetë edhe qyqarë përtej qyqarit. Është mjerim një djalë i ri, prej seancës së parë e ke pasë fjalorin e ndytë, dhe ti kundërmon, edhe fjalori yt. Vernezin dhe Varnakollen mos i nënçmo, janë vendbanime të Vitisë, janë të mrekullueshme, ekoturistike, ka zhvillim rural, janë me traditë kulturo historike, mos i nënçmo, mos fyej, fyemja personale ndaj meje, integritetin tëndë, ty nuk të bënë nder, ty të degradon. Unë po e baj gajle mirë se, unë i dalë zotë vetit. Ti je mjeran, ti kundërmon, fjalori yt kundermon, kurr Vitia nuk ka qenë më në progres se sa është në qeverisjen e Sokol Halitit, tashtë po ta themë. Kurr Vitia nuk ka qenë më estetike, më e pastert, më infrastrukturale, më ambientale, më e ndertume kurr nuk ka qenë. Përskej dobësive që unë jam në gjendje nëpër debate parimore me i pranu, me ish këshilltarin që e dha për ambulant, unë e pranoj që duhet me u funksionalizu ambullanta e Zhitisë. Kurr Verban investime, kurr, me fakte, tashti ja u tregoj një nga një, edhe këshilltareve të Vetvendosjes, me ditë kurr Verban nuk ka pasë investime më shumë se në qeverisjen e Sokol Halitit, prej rrugës që kam lidhë me Goshicë, që kurr nuk e ka pas, prej rrugës që kam lidh Verbanin prej mullirit në Goshicë, prej rrugës që kam lidhë me Begracë, prej rrugës që kam lidhë edhe te varrezat e reja, përmes fshatit krejt, prej rrugës që e kam qu te Sokolt te Fazlia në fundë që gati ka dalë në Goshicë, prej fushave që kam ndreq edhe fushë atje nalt që kam ndreqë edhe në lagje, fushë në lagje. Nuk ka përvec Verbanit askush në Kosovë edhe në lagje ka fushë me tribina, përvec fushave 2 e 3-ta është ajo, 2 që i kemi në fshatë te shkolla, rrethojat rivitalizmi i shkollës edhe katin e 3 kemi punu, me trotuar edhe me rrugë të re të rivitalizume prej Sodovinës. Kurr në Verban më shumë investime nuk ka pasë, edhe uji i cili është para përfundimit që shkonë me projektin bashkë që nuk jam unë kompetentë me fakte po flasë dhe ai që donë me i pranu faktet i pranon, urdhëroni krejt kshilltaret e kuvendit komunal krejtë nga një dhe krejtë lagjet e tjera që i kam shtru unë, shkojmë i hypim autobusit shkojmë i kqyrem investimet në Verban që janë bërë, krejtë, edhe kjo fymje vjenë në këtë formë, ndaj personalitetit tim dhe si kryetarë komune, për atë ja kam bërë

këtij padinë, e ka në gjykatë. Mundet me vanu gjykata padinë, tashtë unë po e shofë që edhe ti je pjesë e ati shkrimi dje që e keni shkru në atë web-faqen fantome, se është i njëjti fjalor. Vec një po ju tregoj, të indetifikum jeni, shumë shpejtë ka me u marrë dikush me këto sene. Nuk e di ti a e dinë që, unë në 1989 jam burgos, nuk e di a e dinë ti, edhe mu më me thanë nuk guxon, ti je mio politik, shkurtpamës je. Vendosmëria jeme është shumë më e madhe sa që mendon ti, por unë jam më institucionalist, unë angazhohem për institucione demokratike, vetëqeverisje që e marrin madnatin legal prej qytetarëve dhe qeverisë. Unë të lus ty vetëm mos me thy, mos me kalu në personalizma, dhe një po themë, mos me quaj ashtu më kryetarin e komunës, unë po të lus, është lutje e imja, nëse unë nuk të dëgjova mirë, e këta tjerët kanë ndëgju mirë, qe ku janë krejtë prezent. Kryesuesit i kamë thanë në seancën e parë, ti me këtë fjalë është dashtë edhe grupi ytë me të përjashtu prej seancës, me rregullore e kam fjalën, ti është dashtë me u përjashtu, edhe sot unë po themë, kuvendi ty duhet me të përjashtu prej seancës me këtë fjalor. Vetëm një po themë që, mjer përfaqësuesit që të kanë zgjedhë ty mi përfaqsu në kuvend. Dije këtë! Se, unë kam qenë vet këshilltar, edhe i ki të ingjizume seancat, munesh me i kqyr, qasjen time cfarë e kam pas edhe si opozitë edhe si pozitë. Edhe ne kemi qenë në opozitë, por mundeni me i pa, merri kqyri se si është opozitë konstruktive, përskejt vërejtjeve, kritikave, anomalive, edhe atëhere ka pas shumë më shumë anomali se tashti, shumë më pakë punë ka pasë se tashti, tashti ka shumë më shumë punë. Kur shtohen punët, shtohen obligimet, natyrisht ka edhe vërejtje, edhe dobësi që unë nuk i mohoj. Unë nuk i marrë krejtë përsipër. Ky raport i imi, vetëm shikoni kujtë i përket, jo vetëm mu, sa zyre i ka, ama unë ta kam bërë me kohë, ta kam bërë në afat, ti kam bërë në Janar pasqyrat, unë ta kam qitë rezultatin 108%, të hyrat 98.52% investimet kapitale, ta kam fitu grandin, rregullarit ligjor te auditori. Ti a e pranon a nuk e pranon, qytetarët e Vitisë e kan pranu edhe e pranojnë. Përskejt fymjet që mi keni bërë, përskejtë web-faqeve fantome, e këtyre sjelljeve më të ulta të mundshme, për skejtë që keni bërë edhe gjatë zgjedhjeve, unë kam fitu se qytetari më ka besu, edhe tashti unë po të tregoj që, kjo sjellje është denigruese dhe e ulët. Për ujin e pranoj kur kërkoni, për trotuar e pranojë kur kërkoni e keni trotuarin e kam ndreq shkëlqyeshëm edhe urën ja u kam zgjenu, për rrugët pranoj nëse ka, vetëm kallxoni cila rrugë është pa shtru në Verban, se i kam shtru krejt, vec gjaje një.

**z.Ramadan Deliu:** Kryesues, vec tu kisha lutë me mbajtë rendin pak më shumë. Gjithë këto punë që janë bërë e qe 3 orë tu kqyrë me i kundershthu pa kurnifar argumenti, 1 urë e ka maru qeveria 3 me 2, krejt qeveria është qu në këmbë me pre shiritin e me i pa komentet e Vetvendosjes ka 2-3 mijë tu shkru tu thanë bravo. Gjithë këto punë që u prezantun pa kurnifarë argumenti me dalë edhe me thy edhe me kqyrë me i kundershthu. Edhe tu kisha lutë kqyre pak kohën, del ai ti lexon edhe unë mundem me i lexu 20 nene, 30 nene pa kurnifar argumenti, pa kurgja hiq. Kqyrme pakë kohën, jepne mundësinë për e fol.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me gjithë respektin për të gjithë, krejtve ju kam dhënë hapësirë me fol. Jemi edhe para kameranve, duhet secili me paraqitë taman atë pozicionin e vetë edhe me ditë sa i takon me folë dhe cka i takon me fol, pa ndërhy te kerkush.

**z.Sejdi Emini:** Faleminderit kreysues! Dole prej rendit të ditës, kështu që po dalim kompletë. Ashtu kështu me fillim pata me fol, mirëpo në konsultim me disa kolegë këtu, disa cka pata me i thënë i thanë këta, nuk e pashë të arsyshme për herë të dytë me i riperseritë. U diskutu te shkolla e mesme rreth një trafo, mirëpo ajo cka më shqetëson mua më së shumti është që, mjaftë shumë debatohet që aty përdoren dukuri negative, sic është narkotik. Eshtë për me u shqetësu me të madhe, se krejtë këto cka po i thojmë, jo i kemi bërë, jo nuk i kemi bërë, nëse të rinjët tanë nuk arrijmë me i hjek prej atyre dukurive që begi janë prezentë, tashti ditë e më shumë po vinë tu u faktu, edhe tu diskutu, edhe tu debatu, atëhere rezultatet e tona janë barabart me 0. Këtë e kam ngritë edhe para 3-4 vite mos gabofsha, mirëpo tashti në kohë të fundit po flitet që janë 2 polic, por nuk mjaftojnë 2 polic me u kanë ata të cilët sillen rreth e rrotull aty, e që besoj që edhe ju që punoni aty mjaftë jeni të informum, është mirë me marrë hapa konkret me kriju siguri. Mendoj që Vitia për me u zhvillu duhet me pas projekte që përime Vitinë e nxjerrin prej zorrës qorre, që është një komunë dikun këtu në periferi të karadakut, kufizohemi me Maqedoni. Ilir, po më doket që shpëtuam pa protesta. Ta kam pas dhanë fjalën që, nëse eventualisht dështon kyqja, jam kanë i gatshëm në cdo formë me u bashkangjitë, mos me zgjedh personin kush është, sepse Vitia del prej zorrës qorre me projekte konkrete qysh është edhe kyqja e autostrates, kemi me pa henez se sa ka me na ndihmu dhe sa ka me na zhvillu, sepse kemi qillu në pozitë gjeografike që kështu si jemi, mirëpo pos kyqjes në autostradë, atë e pata si ide në fillim. Unë mendoj që pos zonës ekonomike poshtë, është mjaftë domethanse dhe kishim përfitu shumë si komunë sikur të ishte bërë edhe një e tillë edhe në Sodovinë, sepse e dimë që kyqja në autostradë e ndihmon fundi fundit edhe me Ferizaj, edhe me Kacanikë. Po ashtu edhe hekurudha është afër. Unë propozoj që të mendohet në këtë drejtim, në bashkëpunim me qeverinë të shpronësohen disa prona, të behet vlerësimi dhe të hapim vende të punës. Në këtë mënyrë, në këtë formë ku jam i sigurtë që Vitia kish arritë në një nivel tjetër. U diskutu mjaftë shumë për disa punë, mirpo nuk u diskutu për impiantin e kanalizimeve, që e dimë që ka të shkojmë rreth Sodovinës shpeshhere ndjejmë erën e kanalizimeve, që nuk është e

mirë. E di që kushton mjaftë shumë, por nuk e di formën si mundemi që sa më shpejtë me eliminu atë problem, që mendoj që është jetike ajo për qytetaret e Komunës së Vitisë. Po ashtu e kam ngritë edhe më herët, është mirë me shty një stacion meteorologjik, tu e ditë që Vitia është zonë bujqësore dhe ka nevojë që energjia të orientohet dhe të kanalizohet në atë zonë, në atë drejtim, për një zhvillim të komunës sonë. E di që vetë nuk bëhet, mirëpo së paku të ndahet një vend ku është i përshtatshëm, gjithëhere tu konsultu me ekspert të kësaj lëmie, dhe pse mos të bëhet edhe një mekanizëm mbrojtës, që i mbron prodhimet bujqësore në komunën tonë. Unë jam idhëtar i asaj që të mendohet për projekte të mëdha, të punohet për projekte të mëdha, sepse në këtë formë, në këtë mënyrë mundemi me i sherby qytetarëve të komunës sonë dhe gjeneratave të ardhshme, tu ja u qel rrugën dhe tu e bë sakrificën ne cka jemi këtu. Kam hala, po nuk po e zgjati për hirë të kohës.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Te projektet e mëdha, ne pajtohemi si qeveri plotësisht. Projekt i madh është projekti që e kemi nis rrugën alternative prej pompës me dal segmenti i parë, segmentin e dytë e kemi më telashe, se na duhet shpronësim për me dal te magjistralja mes kishës dhe lagjes pirovitve. Projekt i madh është rruga për Sllakovc, është 9 kilometra, projekti që e kemi ambicien te Stançiçi, tash pasi ta kryejm Stubllen edhe Godenin, është projekt i madh në rrugën me dalë për Kumanovë, projekti me Kaçanikë të vjetër është projekt i madhë, por edhe projekti që po pretendojmë me lidh prej Budrikës te ura e Remnikut, me pru "Moravën" te Stacioni, me kthy në përparësi dhe me bë në rrugë bujqësore. Kemi edhe projekte të tjera, edhe Sllatinën me lidhë me Ferizaj te tregu me Dardani. Kjo që thu ti, plotësisht ke të drejtë, sigurisht e ki informacionin që Kuvendi kur e ka miratu zonën ekonomike edhe lloton 2 e ka miratu edhe pjesën tjetër të zonës ekonomike në Sodovinë. Ne i kemi bërë, e kemi vendim të kuvendit, plani rregullativ është bërë edhe për pjesën e Sodovinës, mirëpo për shkak të pronave ne kemi mbetë vetëm me pronë publike, që e kemi pas vetëm Budrikën. Domethanë lloton 1, ndërsa lloton 2 kemi bërë kërkesë në krejt qeveritë edhe kjo e ka kërkesën për pronat me kalu në prona të komunës. Nëse kalojmë në prona të komunës, atëhere veç mbetet me negociu me qeverinë, është e nevojshme. Te impiantet, ju e dini që ky Kuvend e ka miratu një projekt që kemi bërë në detal me austriak për trajtimin e ujrave të zeza që s'e thashë. Te uji, edhe një fabrikë 100 litra në sekondë në gryk të "Moravës" për ujë të pijes. Ai projekt atëhere ka vlerën 12 milion e 900 mijë euro, atë e ka nënshkru ministri Hamza dhe ministri Hoti të financave, e kanë nënshkru dy kryeministra, tashti ka ngecë në këtë qeverisje, në Parlament, nuk e kanë qitë, e kanë qitë disa komuna, Podujevën përshembull. Sa për informacion, unë nuk e kam rolin e ankuesit me ju anku Kuvendit, se unë institucionalisht këto sene i kërkoj edhe i qoj, por unë ju thashë më herët, vetëm me ju informu. Unë i kam edhe nënshkrimet e ministrave edhe të kryeministrave, dhe tjetra Kuvendi ka miratu edhe planin rregullativ, kuvendi e ka miratu. Edhe tjetrën, hargjimet për projekt që na kan pagu austriakt, krejt këto janë ecuri, por këtu vynë shtytja e të gjithëve bashkarishtë, mirëpo a e pave, ai thotë për zonë ekonomike. Shikone zonën ekonomike prej hiqit e kemi pru në këtë gjendje, kemi shku para Gilanit-Ferizajit dhe tashti çka fletë zotnia. Kjo është ajo që vërtet të bënë me mëndu, a jeton në Viti a ku jeton. Me qenë njeri kundër vendit të vetë, kundër fshatit të vetë që ka ndërru për 700 shkallë, unë veq ty të kam parë në jetë.

**z.Basri Sylejmani:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Unë veç pak kisha me ndërhy te dokumentari. Ai po fletë vetë dokumentari, nuk po flasë unë. Edhe ndoshta nuk janë 100%, por 70/80% janë, por për juve po del që asnjë sen nuk është i saktë. Edhe ju kolegët e mi për rrymë që folët. Unë po ju jap drejtë se, unë vet kam pas problem me rrymë, e kam bërë kërkesën në Kllokot. Shkoni bëjeni kërkesën, nënshkrimet e juve të katunit kush janë, mua ma kanë leju, 3 lagje i kanë vendos telat e ri. Edhe trafë kemi lyp, trafen nuk na kanë dhanë, se kushton. Edhe për ujë, koleg, ne ujë kemi qe 5 muaj, por ujë të pijshëm. Si tha kryetari, nuk janë bashë të zeza krejt.

**znj.Majlinda Shabani:** Fillimisht, përkuder faktit që unë prej fillimit të mandatit kam gjithmonë, ajo e cila ju kam referu dokumenteve për sa i përket temave, për sa i përket me i ngritë, sot po du me fol për gjendjen reale që e kemi në komunë. Njëra prej arsyeve pse u zgjedhë diskutimi është pikerisht për vetë faktin që, kryetari ndoshta e ka problem me pranu dështimin për sa i përket çështjes së ujit të pijshëm. Përgjigjet që i ka dhënë sot kryetari, këto përgjigje i kam marrë qysh tasht 1 vit, domethanë është kanë seanca e parë kur e kemi pas raportin e punës. Edhe kryetar nuk e di a të kujtohet në debat me Jeta Xharren, ke dhanë premtim që uji i pijshëm ka me u zgjidh brenda muajve, qytetarëve të Komunës së Vitisë po e shofë që po e përmend tërë kohën që ke bërë, takime me ndërkombëtar, projekte. Nuk po na intereson çfarë takime ke mbajtë me ndërkombëtarët, po na intereson se çka ke bë në çështjen e trajtimit të ujrave të zeza, me impiantë të ujrave të zeza. Edhe në spotin që e pamë, u përmendë çështja e arsimit që është prioritet, e në anën tjetër e kemi drejtoreshën e cila ka dhënë dorëheqje. E mua po më intereson me ditë edhe komentin tëndë që e ki në lidhje me këtë. Me stacionin e autobusëve, i cila është në Komunën e Vitisë, çka ka me ndodhë me të. Tek çështja e mbeturinave, unë nuk e di edhe sa keni me vazhdu mu arsyetu si komunë, që nuk është kompetencë e juaja, përderisa unë në Kuvend kam dhanë propozim, që të paktën duhet me bë një ftesë tek një përfaqësues i "Ekohigjienës", me ardhë edhe me dhanë një raport në Kuvend, mandej ne me i paraqitë kërkesat tona

që i kemi ndaj bordit. Për mos me hy në detaje, edhe në pika edhe në projektet të cilat komuna i ka nisë, edhe nuk janë që kanë përfunduar asnjëherë. Unë i kisha dhanë propozim kryetarit, edhe kuvendit, që ndoshta në seancën e radhës me i ftu inxhinierat këtu, që ne me pasë rastin edhe mundësinë me i pyet për secilin projekt që kanë fillu dhe që nuk kanë mbaru asnjëherë, se asnjëherë nuk është që kemi marrë përgjigje. Kemi rrugë në fshatin Lubishtë që kanë fillu në kohë fushate dhe nuk është që kanë përfunduar, edhe që realishtë ne nuk e dimë. U përmend edhe bugjetimi gjinor, unë kam dhanë propozime edhe për sa i përket bugjetimit gjinor, por nuk është që janë marrë parasysh asnjëherë. Kolegu Ilir e përmendi edhe bashkëpunimin që duhet me qenë bashkëpunues e në aspektin e bashkëpunimit, po besoj që sot e keni dhanë përgjigjen edhe kur kenë në pyetje interesat e qytetarëve. Për sa i përket dëgjimet publik, ndoshta është mirë me i marrë parasysh më shumë kërkesat se sa me figurë numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në dëgjime publike, se për çdo vit shkon tu ra qaj numër, për vetë faktin që ata janë të zhgënjym, kërksat e tyre domethanë nuk është që merren parasysh. Falemindert!

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues, kur jemi te raporti i kryetarit për periudhën Janar-Dhjetorë 2022, u tha shumë nga parafolësit dhe unë nuk dua të elaburoj shumë, por do të mundohem të jemë sa më i shkurt edhe të ja përforcoj atë të zezën Basriut. Do të ndalem në fillim te Zyra e Prokurimit, thuhet në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, Zyra e Prokurimit ka përgatitur këtë raport për kryetarin e komunës, që i bie ky është raport i Zyrës së Prokurimit, nuk është raport i kryetarit të komunës, prandaj edhe personi përgjegjës për prokurim nuk ka dhanë asnjë fjalë të vetme, përpos që i ka numru këto aktivitete dhe të bëmat pozitive të tij që janë bukur si të mira në numër, por nuk figuron këtu fare problemi i shefit të prokurimit. Pse? Ka qenë i arrestuar, ku është çështja ta dimë edhe ne, edhe pse gjithë ky besim i plotë tek ai, kur në anën tjetër për një fjalë goje që e shkrun një gazetë apo dikush tjetër për dikan, se nuk po du me hy më konkret, qohen peshë, shkarkoje, ngarkoje. Pse ju nuk shkarkoni? Pastaj është edhe një zyrtar tjetër që është i dënuar për tek konkursi i studentëve, nuk është marrë mas fare ndaj tij. Domethanë, ne përpos të arriturave pozitive që i shohim këtu, edhe që i pashë një pjesë pak në televizor, që është hera e parë që pa biletë po shofë filëm, por si do që të jetë është diçka tjetër, pse edhe këtu nuk na jepen neve ti dimë edhe ne se deri ku ka ardhë çështja. Mandej te Zyra Ligjore, e cila në pedestal, domethanë nga kryetari u promovu. Ne këtu e dimë të gjithë, jo vetëm ne të Vetëvendosjes, se sa vendime na janë kthyer nga MAPL, pikërisht për shkak të jo përputhshmerisë ligjore, prandaj edhe kjo është dashtë të ceket këtu, deri ku ka ardhë ajo. Tek Drejtoria e Arsimit, krejt e dimë çfarë punësime janë bërë në Drejtorinë e Arsimit, janë bërë me sms, me ryshfet, me të gjitha metodat janë bërë. Ka edhe landë tashtë në gjykatë, këtu së paku me na dhanë 1 fjalë 2, me thanë që këto që i keni dëgju edhe që kanë qenë, nuk kanë qentë të vërteta, por vetëm fjalë boshe, kështu të koloareve, po te drejtoria nuk po dua më shumë me diskutu, edhe për faktin se drejtoresha ka dhënë dorëheqje. Pra, këtu no koment. Dua ta pyes, nuk e di a kryetarin e drejtorin e financave, por ai iku. Nga cili buxhet janë bërë këto përgëzime, nga kryetari i komunës të cilët në shkollën e mesme “Kuvendi i Lezhës” i kanë sjellë për secilin nxënës nga një copë të tillë për të ja uruar vitin e ri. Nuk e di unë se çfarë forme është kjo, edhe prej kurit është në funksion. E kam edhe një pyetje për kryetarin, se thojnë kush të qeshë i fundit qeshë më së miri, e ndoshta qeshë i fundit. Kur do të rrjedhë uji në rubinetat e qytetarëve të fshatit Remnik, sepse ky është mandati i 3-të që je si kryetar i Komunës së Vitisë, në të njëjtën kohë edhe i qytetarëve të fshatit Remnik, të cilëve ja u ke marrë votën ose ju ke premtu që do ta zgjedhësh problemin e ujit të pijshëm dhe nuk ke ndermarrë asnjë gjë që atëherë, që tashti je në mandatin e 3-të, ku dihet që edhe rrjeti është i shtruar nga kryetari paraprak, Nexhmedin Arifi.

**z.Basri Sylejmani:** Unë veç e kisha lutë kolegun, në qoftë se ti ki fakte dhe argumente, që ku është prokuroria. Unë me u kanë në vend tan me cekë atë, unë shkoj në prokurori edhe e qoj në prokurori. Thamë, kjo është ajo, ne të mirret tani me kryetarin, ose me mu, ose me Bekimin, ose me atë. Qajo është e jo veç me fol.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit! Është një përmbledhje e shkurtë e kryetarit, ka takim.

**z.Durim Sylejmani:** Është raporti i kryetarit, me nejt derisa të kryhet, deri kur të shterret debati.

**Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti:** Unë për debat tëndin nuk jam i interesum bash hiq. Nuk është fymja debat, dhe tjetra, fjalori yt.

**z.Durim Sylejmani:** Ti e ke nis këtë fushatë në media, ti ke bërë së pari herë ke bërë në vitin 2017 ndaj Sali Salihut kesi fushata të flliqta. Unë nuk kam nevojë hiqë me folë pas shpine, foli qëtu, nuk kam nevojë me u mshefë hiq.  
(nuk kuptohet qka flitet sepse flasin shumë persona)

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** E di një që, fjalorë më të ulët kush në Kuvend, në krejtë kuvendet nuk ka pas si ti.

(nuk kuptohet qka flitet sepse flasin shumë persona)

**z.Durim Sylejmani:** Tjera here kryesues ma jepë fjalën.

**Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti:** Unë kurr kundër Sali Salihut një fjali nuk e kam folë, as kundër kundërshtarëve asisoji, unë në kuvendet e Vitisë fjalor më të rëndë se tëndin nuk kam parë. Çështje e jotja, grahi ti, edhe unë po të themë që janë organet juridike që i drejtojnë këto punë, ja ke qitë kalemin, në rregull, edhe bollë më mos e tepro, mos e prish klimën e debatit, leje bollë më. I nderuar këshilltar Remzi, te çështja e ujit në Remnik. Është e vërtetë që nuk është kanë projekti i qeverisë teme, është kanë e ish qeverisë, e the mirë. Tashti a duhet ne me rikthi atë me rivitalizu, është temë që duhet me diskutu dhe me rikthi. E the vetë, në rregull, po ti mua po më akuzon edhe pe qetë vetë që u kanë ish projekt edhe i Zhitisë, Skifterajt, Beguncës, po në rregullë unë e pranojë që ne duhet me rirregullu çka të prishet duhet me rirregullu. Unë po themë të bëhemi parimor, të flasim me argumente, nuk jam tu dashtë me folë pa argumente. Drejtorja e Arsimit, Zyra Ligjore kurr nuk ka punu më shumë e më mirë, zyrat kanë ardhë në kuvend, por mbi të gjitha Zyra e Auditimit, Zyra e Prokurimit, zyrat e caktume, ka njerëz jurista dhe njerëz që e njohin, e kanë obligim Komiteti për Politikë dhe Financa me qu raportin edhe e kanë afatin ligjor që e qojnë në KPF, e keni përfaqses edhe grupet parlamentare i keni përfaqsesit e juvë, ata i kanë me ligj, i qojnë, por nëse duhet nuk ka problem edhe zyrat edhe krejtë, gjithmonë kemi thënë që transparenca ka me qenë në nivel. Kanë me ardhë në Kuvend, kemi me debat, kemi me diskutu gjithnjë brenda argumenteve, jo me fymje, mos e fusni në fjalorë, se nuk është në rregull, kanë me ardhë të gjithë cilën të dëshironi kanë me ardhë, zyrat janë bashkëpunuese edhe unë insistojë me ardhë nëse ju thuni sikurse thotë këshilltarja me ardhë inxhinierat. Po folëm edhe për Lubishtë, edhe për projektin e ujit që është ndreq më herët, por nuk është tu funksioniu. Folëm për të gjitha, nuk ka problem, veç me fjalorë konstruktiv, ani kritikë në vetëdijen e kërkimit, përgjegjësisë forcone sa të mundeni, edhe unë jamë për atë, nuk jam duke e mbrojtë askënd, se qenkan këtu edhe zyrtarët kryesor që merren edhe me burimet njerëzore, nuk jam duke e mbrojtë askënd që e shkelë ligjin, vetëm një po të themë, ligji duhet me thanë fjalën, nuk mundet me thanë politika fjalën para ligjit, para vendimit gjykatës, nuk mundesh ti me shkarku as me largu askënd pa procedurë, ne e kemi pas këtë çështje edhe te komisioni, nuk mundeni as në listë të zezë me shti askëndë pa komision, as kryetari, prandaj në këtë kuptim e kemi pas luftën për rregullaritet. Ne e kemi luftën për rregullaritet, mos harroni, në emër të demokracisë ne nuk mundemi me kalu me një tjetër aspektë, e njerzit me i paragjyku, e me i denu pa i denu ligji e gjygi. Jo, shteti i rregullum nuk e bënë atë. Në këtë kuptim ne duhet me pasë kujdes. Unë përshembull e kam vetë zyrtarin, i kamë thënë, sa ankesa i kemi, 400 landë, 4 ankesa, 2 janë tërhekë, 2 ju kanë kthy. E tashti kur ta kthen organi, unë tashti kujtë me i besu, a me i besu organit a me i besu fjalës tënde e të atij që fletë, kjo nuk shkon në shtet, komuna, institucioni nuk funksionon ashtu. Unë po ju tregoj drejt, unë nuk punojë pa vendime të organeve, kjo është esenca, edhe në fundë të fundit demokracinë e zhvillojnë rregullat, ligjet. Ligji mbi Vetëqeverisje Lokale i ndanë përgjegjësitë, i ka të caktume, përshkrimet e detyrave të punëve i kanë secili, prandaj në këtë kuptim duhet me mbrojtë të gjithë. Edhe kuvendi ka kodë etikë, edhe ka rregullore, jemi tu e shkelë, jemi tu e tejkalu. Unë po themë që nuk është mirë me tejkalu dhe me shkelë duhet me bashkëbisedu, shumica merrë vendim dhe nuk bënë kështu me shkelë. Stacioni i autobusëve këshilltarë e the, mos të mbes borgj, se e kam një tërmin. Unë kam ardhë në aspektin ligjor me përmbushë, me ja dorëzu informatën, e keni tashti pasqyrën financiare, në dataje drejtori e mbronë. Stacioni i autobusëve e dini siç ka qenë e siç e kemi kthy. Ne e kemi qitë kështu në Kuvend që ju e keni kundërshtu stacionin e autobusëve me bë me 6 të punsum, edhe me rregullu me mirmbajtë, e keni kthyer mbrapa. Unë mundem me rikthi prapë, se nuk e kamë bërë për veti, e kam pas që të ketë efekte pasuese me mirëmbajtë, pse e kundërta është, duhesh me kriju kompani publike të cilën ne nuk mundemi, se 7 vetem bordi ti merr, a mundesh me pagu edhe 7 punëtor, 14 nuk mundesh dhe nuk mundet me mbijetu, prandaj ne jemi lidhë me regjion siç kemi qenë me mirmbajtë, me rregullu edhe me pas efekte pasuese, por edhe funksionalitet. Investimin e kam bërë, shumë më mirë është për mua me funksionalizu, por kur ta bijë në Kuvend, ju atë vendim e keni kthy dhe unë me kallxu që nuk kam ndonjë gjë aty, nuk kam reagu fare. E keni kthy e keni kthy. Si ekzekutiv unë ju bi vendimin në interes të qytetarëve, ju mos e votoni, por unë e kam për detyrë me ju thanë që, kjo është e mirë, e mirë është me votu stacionin e autobusëve, është dashtë me votu atëhere kur e kam pru në kuvend, e tashtë pe rikthen ti që e ke kundërshtu. Shembull po e marrë, se ndoshta ti nuk e ke kundërshtu, se nuk i kam kqyr votat, por shembull. Te uji i pijës, unë ju tregova ku e kemi pa zgjidhjen për ujë të pijës, ju kam thanë shumë here, për shkak që jam interesu, i vynë 100 litra në sekondë Vitisë për kokë banori me ujë. Ne i kemi pas 40 litra tu u përpunu, 60 litra i kemi pas ardhje, kemi punu për 20 litra me i përpunu me klorafikim gazë, por na kanë mungu edhe 40, prandaj unë e kam propozu një fabrikë 100 litra në sekondë. Dëgjimet publike qe ku e ki listën e dëgjimeve publike që i kemi mbajtë, nuk ka komunë në Kosovë që i ka mbajtë dëgjimet publike as për bugjetim gjinorë e kemi venin e parë në Kosovë. Kryesues, këshilltarë, unë ju falenderoj shumë të gjithëve, me respekt të veçantë të gjithëve që keni qenë konstruktiv edhe e keni ndëgu Informatën e punës 2022. Do të vazhdojmë me referu edhe për 6-mujorin, fazën e planikimit. Ju ftojë të gjithë me ndihmu dhe me i dhanë sygjerimet dhe mendimet e juaja edhe për lokalitetet e vendbanimeve prej nga vini.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Të nderuar antarë të kuvendit, mirë se keni ardhë në pjesën e dytë të seancës të parë të rregulltë të Kuvendit Komunalë në Viti, duke vazhdu me rendin e ditës.

Si pikë të tretë e rendit të ditës:

### 3. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2022

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë! Drejtorë, na falë, por këtu në përfundim të pjesës së parë të kuvendit e patëm një incident, meqë rast u sulmu fizikisht një prej asamblisteve tanë prej disa personave që nuk e di se çfarë funksioni kanë dhe ka janë, edhe deshta me ditë si kryesues çfarë veprimi e keni marrë këtu për këtë rast që është bërë, se ne kështu nuk mundemi me vazhdu. Të paktën jemi përfaqësues të popullit dhe e kemi një trohë dinjitetet. Ne jemi sulmu si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje prej disa huliganëve që nuk e dimë kush janë ata. Ka pas këtu edhe zyrtarë komunal që na kanë fy na kanë sha, për atë unë nuk i kam ndegju, por fletë Majlinda konkretisht, për kë është fjala dhe kështu nuk mundemi me vazhdu nëse nuk keni ndermarrë diçka për këtë seancë, ne nuk mund të marrim pjesë, nuk mundemi me kalu në heshtje, gjithë çka ka ndodhë, një e pamë që ishte shefi i kabinetit, Jakup Haxhiu dhe të tjerë që ishin me ta. Të dimë kush janë dhe për çka e kanë bërë këtë e keni ndermarr diçka, ajo që gjithçka ndodhi nëse nuk keni ndërmarr diçka atëhere nuk e di, jeni kryesues na përfaqson të gjithë kuvendin edhe neve në këtë rast edhe të bie barra. këtu ka sene të mira, por edhe të këqia, duhet me u marrë me të gjitha edhe ja kisha kalu fjalën edhe ajo ne ta thotë.

**z.Majlinda Shabani:** Faleminderit shumë kryesues! I bashkangjitem pikerisht atë çka e tha shefi i grupit, realisht edhe unë isha prezentë gjatë diskutimeve që janë bërë edhe gjatë gjuhës denigruese, edhe mund të themë që kamë qenë pjesë e sharjeve që janë bërë këtu, bëhet fjala pikerisht për zyrtarët të cilët janë të punësuar, domethanë në komunën tonë edhe janë prezentë këtu edhe na këtu para kuvendit domethanë potencojmë që këta persona nuk e kanë vendin këtu. Ne edhe si opozitë edhe si grup, mirëpo edhe gjatë sulmit që ju ka bë fizik asamblistit tonë ke me i ndëkjë procedurat ligjore të drejtësisë edhe kemi me i paditë këta persona me emra, duke i përfshi këtu edhe zyrtarët të cilët kanë përdor gjuhë denigruese dhe na kanë sha. Faleminderit!

**z.Remzi Salihu:** Edhe unë dashta me u nderlidhë këtu te zyrtari i personelit, e pata unë një debatë para se me dalë atje me Hysen Imerin, edhe tha unë jam ai që i kry këto procedura tha, po mos folë këtu po shko në prokurori. Thash në prokurori unë nuk shkojë, se faktikisht prokurori i ka qeto punë, më nin mua tu folë e shefë që nuk është në rregull, ma bënë padinë mua ose e bënë padinë për rastet që i paraqes unë dhe i thashë që unë vazhdimisht këtu ka me fol, në prokurori nuk shkojë, fatbardhësisht me mua nuk e ka zgjatë më shumë se nashta kurgja nuk kisha bërë por e kisha detyru me më sulmu, qëta e kisha bë. Kush është ai me mu kërcu edhe kur ka dalë në korridor ka folë fjalë fyese, deri sa edhe sharje, prandaj si kryesues është dashtë me diskutu qoftë me grupin nga partia e cilës vjen, qoftë me kryetarin se ka ikë tashti, se ka takime, vazhdimisht ja bënë qështu, po nuk është ndermarrë kurgja, prandaj këto shqetëisme po i paraqes këtu dhe mandej vazhdojmë tutje. Faleminderit!

**z.Ramadan Deliu:** Unë kesh prezentë edhe brenda edhe jashtë, nuk besoj që është kanë kurgja më shumë jashtë se sa mrena, sulmi ndaj kryetarit edhe jashtë kenë fjalë thash e theme. Shefi i kabinetit unë nuk e kam parë që ka sulmu dikand, e pashë se erdhë më vonë me marrë kryetarin me kerr, e po quditem që po thonë sulm. Kurgja nuk është kanë sulm jashtë çka është kanë brenda ndaj kryetarit, e për çka folin gjinja masi të dalin, secili e ka gojën e vetë folë për veti.

**z.Jakup Demiri:** Dan, mos e merr personale, por ty nashta duket kurgja qëkjo, ne e pamë reagimin dhe shajret në fund të Jakup Haxhiut, më shkurtë ai i shajti krejtë, a e ke ni a se ke ni është çështje tjetër, tu të përfshi edhe ty. Në fund të fundit të gjithëve, nuk është kjo me kalu kështu, nashta dikush e përbinë, por unë nuk muj me përbi. Përvete kështu nuk funksionoj, kryetari ka qenë rrallë në seancë por sa here që ka qenë prezent kryetari i ka riaktualizu, i ka dhezë këto tema, edhe sot merrne kqyrne, por kqyrne pa anshëm, se nuk jemi ne për me pru në kësi gjendje, por kjo gjendje për mua nuk kalohet, po flasë edhe për grupin tim që përfaqsoj, se unë nuk vi këtu edhe me dalë si thojnë bishtin ner këmbë, e kam një tro dinjitet të cilën mundohem me majtë dhe me rujtë. Përfaqësoj grup parlamentar, përfaqësoj veten dhe familjen, kujna ti mteket këtu me ardhë me bë asi skena, me sulmu, te unë nuk kalon e për ata që nuk kalon këtu është dashtë me ndërmarr diçka kryesues. Policia duhet me qenë këtu, se përndryshe ne nuk vazhdojmë.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë po foli në emër të grupit. Ne distancohemi prej këti rasti që e pamë, nuk ke i heshtim. Unë edhe njëhere po aludoj që kryetari i komunës saher të vjen këtu krijon situata për shkak të provokimeve që i bënë. Ne si grup distancohemi prej këtyre gjërave të pahijshme që ndodhin pasi përfundoj seanca e Kuvendit Komunal Faleminderit!

**z.Ali Bajrami:** Ajo çka ndodhi nuk është e jeshme, pavarësisht prej kujtë dhe si ka ndodhë. Unë jam atë çka ka ndodhë ne të ndjekin ato procedurat ligjore krejtë kjo çka ka ndodhë pasi që ti e ke mbyll seancën. Unë jam që kuvendi të vazhdon me punime, e këto tjerat ne t'i ndjekin ata, nëse ka fakte argumente janë organet ne të vazhdojnë me procedurën. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këto shqetësime janë të përbashkëta, sepse ne jemi tek e fundit një, jemi të gjithë antarë të Kuvendit. Sot mundet me pasë dikush një debat, nesër tjetri, domethanë nuk mundet t'i anashkalojmë këto pse janë të dikujt ose pse sot nuk më rroki mua por pjesa e debatit mund të na kapë secilit, pjesa e rregullt ka qenë seancë live dhe përfundimi i seancës është bërë dhe pjesa deri sa ka qenë seanca që unë jam përgjegjës deri sa është seanca, gjithçka çka ndodhë është pjesa e përgjegjësishë teme që me u marrë me çdo sen që ndodhë këtu brenda seancës unë jam përgjegjës. Me ndodhë jashtë seancës, çka ndodhë kalonë në qcshtje individuale. Ne mund ta denojmë si grup, si akt, por zgjidhjen e njerëzve që janë jashtë kuvendit për pjesa e jonë që jemi këtu, ne mundemi me pa se është edhe praktika që ka edhe eskalime shpeshhere edhe nëpër kuvende të Kosovës, nëpër vende të tjera. Ata çka janë brenda neve, ne duhet t'i zgjedhim me debate, me forma të ndryshme që na takon, sepse kemi votë dhe kemi përgjegjësi. Pjesa jashtë seancës, domethan që ka ndodhë, të jem shumë i sinqert, unë kam qenë te rruga më vonë kur e kemi pa që ka më shumë njerëz, jemi kthyer prej rrugës me Muslinë, personalisht nuk e kam parë atë pjesën e debatit që ka qenë. Nuk e di atë çka ka ndodhë saktësisht, vetëm çka e kemi bisedu me Alinë, me Durimin e me juve në përgjithsi çka ka ndodhë. Të njëjtin debat e patë edhe Taulanti, të njëjtën formë, të njëjtën formë nuk e ka pas, por ka pas një formë të debatit të tillë, që është e pahijshme, nuk na takon neve, mirëpo ne duhet ta menaxhojmë vetë nëse një element i sigursë nuk është në sallë, ku jemi tu e majt seancës atëhere. Unë mund të marrë masa, mund t'i thërras policinë, mirëpo pjesa e seancës që është tu vazhdu është në rregull, e kemi në përgjegjësinë, këtu nuk ka elemente që nuk ka siguri me mbajtë seancën, mirëpo nëse ka ndonjë element që je i rrezikum në pjesën që jemi, atëhere unë i marrë masat e sigurisë. Për pjesën tjetër gjithsesi çdo veprim që ndodhë jashtë këtuhit, unë e denojë publikisht veprimet që ndodhin që nuk na takojnë neve për gjithësecilin.

**z.Jakup Demiri:** Është e vërtet që ka ndodhë në kohë të pazues, por ka ndodhë brenda objektit të cilin ti e përfaqëson kryesues, brenda kuvendit, në derë tu dalë janë sulmu njerëz me grushta edhe kjo me kalu në heshtje, unë nuk e mendoj që është gjë e mirë kjo. Del dikund tjetër, del te një presion tek asamblistët që ai që nuk e mshel gojën ndryshe me provu edhe kështu, e ti e ki obligimin parësorë që me siguru këtë punë, që asambleisti me kanë perime ai me dhanë mendimin e vetë. Unë nuk mendoj që kjo me kalu në heshtje edhe nga ana jonë, për atë mendojë që këtu nuk ka kushte për me vazhdu, se dikujtë ju ka prekë dinjiteti, çka ka me i kqyr pasqyrat fianciare të tjera kur jam ardhë, jam sulmu dhe krejtë në rregull është. Faleminderit, ne nuk vazhdojmë më me këtë seancë. Po e shofë që ndoshta është problem kourumi për juve, por me neve nuk vazhdon. Ne e kemi vendim, nëse nuk keni ndermarr asgjë nuk është vetem çështje sigurie, por është çështje dinjiteti, ti i përfaqëson Bekim asamblistat dhe tu ka sulmu një asamblist sot ty edhe të gjithë neve, por jo veç një ata e kanë nis, pale kur perfundon. Ne nuk do të jemi pjesë e punës së pjesës së dytë të Kuvendit për arsye të lartë cekura dhe nuk do të jemi pjesë e kësaj seance.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Vendimet e juaja janë shumë të respektushme, është veprim që është i lejshem me lëshu seancën. Ka pasë raste kur edhe ne e kemi lëshu seancën, mirëpo për këtë seancë unë nuk shofë asnjë element që nuk ka siguri me lëshu seancën.

**z.Jakup Demiri:** Më e palogjikshme kryesues me duket kur ne e trajtojmë këtë ambient vetëm në aspektin e qenies biologjike, të tjera nuk paskan rëndësi, nuk është kështu sot. Mendoj që pas atij akti është dashtë të permbyllet seanca për një kohë bile, të merret dikush me të, se jo qështu. Nuk është problemi i sigurisë, se sigurinë fund i fundit i sigurojmë vet vetes ne, masi nuk ka ndermarr askush asgjë këtu, faktikisht po na bjen me u marrë vetë me veten. Ama në këtë gjendje kështu pas asaj pa u ndermarrë asgjë, pa asnjë reagim, atëhere me të vërtet kjo është edhe shej mos respekti.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Jakup, kërkove a ke ndërmarra diçka për siguri, se pa pasë elemnte të sigurisë the nuk mundem me vazhdu. Unë po konstatoj që nuk ka element që nuk është diçka e sigurtë këtu për me vazhdu seanca. Në momentin që e kemi këtë element të mossigurisë, e thirri edhe policinë edhe e mbajmë pjesën. Këtë çka e kërkove për me të kriju kushte për me mbajtë seancën, unë atë nuk e shofë atë elementë. Çdo element që ka ndodhë brenda seancës është e ingjizume llajv, për çka e kam përgjegjësinë unë edhe ligjore, edhe njerëzore, morale. Çdo element që ndodhë jashtë seancës e kalon anën zyrtare të Kuvendit. Për këtë ka prokurori, ka gjyqësi, ka edhe polici.

**z.Jakup Demiri:** Bekim, të thashë te puna e sigurisë kur erdha unë, nuk e disha, tash po e shofë por nuk ke vetëm kjo, se unë të pyeta, a keni ndërmarra diçka edhe unë kështu me këtë grupin tem nuk marrë pjesë në punimet e pjesës të dytë.

**znj.Majlinda Shabani:** Ambient fizik kemi për me mbajtë seancën, mirëpo ambientë psiqik nuk kemi realisht. Nën presionin që e patëm më herët, nuk mundemi me u sillë sikur jemi në një situatë normale edhe me trajtu pikën që kemi me radhë me seriozitet, me shumë konsiderasë ndaj përgjegjësish që e kemi ndaj të gjithëve. Me situatën që është kriju këtu ne nuk mund të vazhdojmë.

**znj.Liridona Bislimi:** E përshendes diskutimin e shefit të grupit të PDK-së, ndërsa për dallim prej diskutimit të grupit të PDK-së, unë faktikisht nga diskutimi i z.Deliu e kuptova në një formë se çfarë paska qenë gjithë kjo tollovi, gjithë ky sulem. Në momentin kur vjenë këtu dhe e përsëritë prapë diskutimin që e kemi bërë në raport me punën e kryetarit, tash në një farë forme po i bie që, kur të vie raporti tjetër i kryetarit apo pa marrë parasysh ndonjë raport tjetër, ne opozita duhet të kemi kujdes, duhet të mendoj dy here se çka po flasim në Kuvend, për shkak se nuk e dimë se çka na pret jashtë. Kryesues, kur e ke fillu këtë pjesë të seancës, nuk besoj që ke pa ndonjë rrezikshmëri ose nuk besoj që dikush e ka ditë që ka me përfundu në këtë formë, por ne tash ja ku jemi, seanca po duket e qetë, mirëpo ne nuk mundemi me ditë se çka ndodhë jashtë vazhdimisht, jemi përballur nga jashtë me kërcnime, me analiza të kryetarit Sokol Haliti në momentin kur kemi bërë diskutime, në momentin kur kemi bërë reagime, qoftë në rrjete sociale, ne prej simpatizantëve të subjektit të pushtetit në Viti kemi pasur kërcnime, lloje të ndryshme, qoftë në mendatin e kaluar. E dinë edhe ti, kemi qenë bashkë opozitë, tashti çka po ndodhë në momentin që ne nuk jemi stopu po vjenë puna ndoshta edhe te grushti. Kjo përlëshja që ka ndodhë ka ndodhë në këtë pjesën këtu, unë kam qenë e fundit që kam dalë prej sallës, ato sharjet, ato fyerjet që i kemi marrë sidomos ne gjinia femërore, për mua nuk ka qenë e hijeshme me ardhë në Kuvend Komunal dhe me ndëgju atë diskutim nga shefi i kabinetit. Unë personalisht e kam ndëgju atë duke bërë sharje, fyerje të cilat nuk i dëgjoj as në rrugicat prej njerëzve më të thjeshtë, prandaj kjo seancë, kjo ngjarje për neve nuk mundet me kalu në heshtje, ne nuk mundemi me dëshmu se jemi tu ndi me një formë të friksum prej kësaj që ka ndodhë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me gjithë respektin, nuk besoj që ka dikush që i ka dhanë më shumë hapësirë me diskutu pa ja ndërpre fjalën kujt, me lanë komplet minutazhën me tejkalu, sadush. Ju e dini rregulloren, 3 minuta ta jep, nuk ka asnjë që ka fol 3 minuta, se 4 or ka zgjatë pjesa e parë, veç e kemi lanë mundësinë me bisedu, me diskutu me krejtë. Nuk kam pas interes me ndërhy te asnjëri, por me diskutu edhe temat edhe raportin.

**z.Ramadan Deliu:** Unë e pata qëllimin mos me i dramatizu senet sikur e kanë zanat, nuk është bërë më e madhe edhe nuk besoj që bëhet, e sapër mbajtje të seancës, është gjujtë gazi lotsjellës, është gjujtë spreji syve, e seancat kanë vazhdu prapë. Nuk është bërë mirë që ndodhi, nuk ka arsye mos me u mbajtë seanca.

**z.Ali Bajrami:** Nuk jam as me i zmadhu gjërat, as me i zvoglu. Sa i përket sigurisë që tashtë kemi fillu vitin e 10-të këtu me disa kolegë të subjekteve tjera, e kemi rujtë kodin e mirësjelljes, edhe etik edhe moral, pikërisht për mos me ardh këtu. Jam çdo veprim me u sanksionu, por nuk jam veprimi me zgjidh kundër veprimin edhe mos me vazhdu mos mu mbajtë seanca. E ceku edhe kryesuesi se, edhe për të ke shqetësuese, edhe për mua Liridon. Ti po thua e fundit ke dalë, por i fundit jam kanë unë, se jam kanë në telefonë tu fol, edhe aq keq e kam ndi veten, kam komunikue me Jakupin, me profen, me Durimin, nuk na ka hije me këto veprime. Ju mirë thatë, jemi të zgjedhurit e popullit, kur të na shohin ata qytetarë këto gjëra duke i bërë, atëhere kanë me thanë: “kuku për ne çka pasmi bë”. Unë jam që seanca me vazhdu, procedurat në të vazhdojnë. Nuk është në rregull për mua, është shumë esenciale që nuk ka pas sulm verbal mes këshilltarëve komunal, është shumë me rëndësi kjo, prandaj po i themë këto çka i thashë.

**z.Jakup Demiri:** Janë disa gjëra që ne i kemi në telefon, po i shpalosim pak. Situata nuk është veç kjo çka shihet, veç ju qka e shifni, është shumë më e madhe për disa tema që neve na shkruajnë në privat, e sot ne mirë e dimë se çka është tu ndodhë me këtë invazion, me këtë sulm që është bërë sot, madje ne si opozitar që po jem, po e themë edhe këta pe kem problem me pi kafe me disa miq, shokë, madje lidhje familjare që shkojnë dhe i sulmojnë e i shantazhojnë që po pini kafe me atë. Pikërisht po flasë për vete, kam njerëz qe 10 vite pi kafe, deri para 1 viti 2 si kanë pa tu pi kafe me mu, se di në rregull bile kemi pi bashkë kafe, e tashti ka ardhë deri këtu muhabeti edhe kjo nuk mundet me vazhdu. Unë nuk vi si dele këtu. Ja vi qysh jam ja nuk vi hiq, ajo nuk kalon te unë, se unë e di veten, se unë atë nuk e përbi, mirëpo mosveprimi i kurgjahiqit, as mos me qelë si diskutim bile 5 minutsh për atë ngjarje që ndodhi, kjo pak na shtin me na fy. Tashti kryetari qe 1 vit thotë kam qu akuza ndaj juve, ky është shantazh. Që the po ju japë hapësirë, e di, por sot nuk ke që banem ne pyetje, ku me ditë sa murrem kohë, se unë pyetjet e dyta që pata me i bë për qytetaret që i kemi të fuzirata, sot temat nuk arrita hiq me i bë. Ai e kishte raportin, folke për projektet të cilat i ka pjesën më të madhe të kohës kush e murr nuk është faji jonë. Ne jemi opozitë, ne kemi me i ngritë shqetësimet, koha që shkoj mas 2 nuk shkoj prej neve si dalke aty ai nuk u ndalke tu folë për projektet e ardhshme, për ministri, për ato, fol për raportin tëndë edhe u kry. Mos të ju marrim kohë juve, ne nuk do të jemi pjesë e kësaj. Ju kisha lutë për mirëkuptim.

**z.Musli Neziri:** Unë plotësisht e kuptoj grupin e VV-së në këtë rast dhe nuk du me amnistu asnjë. Ne jemi të gjithë të zgjedhurit të popullit këtu dhe nuk dua të kalon kjo gjendje ashtu. Nuk pajtoj me Danin asesi të kalon në heshtje, sepse ne të gjithë e dimë që në sallë nuk ndodhi, dhe nga aspekti i sigurië pata qef me qenë edhe këta, se nuk pat cenim të sigurisë, nëse nuk dojnë me nejtë në sallë është e drejtë e tyre, por a guxojmë ne si deputet të zgjedhur të Kuvendit Komunal që të heshtim ndaj një kercnimi që vjen dikush nga jashtë dhe të sulmon, kjo i ka ndodhë sot VV-së, neser mund t'i ndodhë PDK-së ose LDK-së, prandaj kjo është e dënushme. Unë e shofë që është shumë tendencioze kjo nga jashtë me ardhë me të sulmu këtu pranë derës së kuvendit, dhe të gjithë jemi dëshmitarë se, qaty ndodhi, asnjë mos ta hupim tashtë temën, unë s'e pashë, unë e pashë. Unë te taksistat kesh e ndëgjova bërtimen se çka ndodhi, prandaj ajo është e pahijëshme, duhet ta denojmë të gjithë bashkarisht, nuk duhet me leju me ndodhë një rast i tillë, nuk pajtoj kurr me këta dhe kushdo qoftë, qoftë i VV-së, PDK-së, LDK-së, unë duhet t'i dalë kolegut tim në mbrojtje dhe jo të kercnohet nga dikush prej jashtë. Sot është sulmu dikush, tentim sulmi nga jashtë jo nga Kuvendi, jo mes neve, por nga jashtë, dhe prandaj nuk duhesh me pajtu. Dan ty po të drejtohem, nuk duhesh me pajtu me këtë.

**z.Ramdan Deliu:** Nuk thashë që e përkrahi por thashë shqyr që nuk është bërë më e madhe, edhe ndashë me kanun, ndash qysh do të madhen është mirë me bë të vogël të vogël, me hupë krejtë. As djali jem me u kanë nuk e përkrahi.

**z.Illir Zuka:** Edhe shefi grupit parlamentarë që na përfaqëson z.Ali Bajrami shprehi keqardhje për atë që ka ndodhë, shprehi keqardhje edhe Taulant Haxhiu, edhe ne të gjithë asamblastët shprehim keqardhje, po nuk është interesant secili ne tashti me dhezë mikrofonin me thanë po më vie keq, për shkak se e kemi një përfaqësues që e kemi zgjedhë vet grupi. Kështu, unë po mendojë me vazhdu me seancën se ka kalu kohë e gjatë dhe i kemi disa pika pa kalu.

**z.Besnik Imeri, drejtor:** Përshendetje për të gjithë! Më lejoni që para jushë të paraqes pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore të Komunës së Vitisë, duke u bazuar në ligjet, në vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Meneaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Në këtë periudhë Janar-Dhjetor 2022, buxheti i alokuar ka qenë 14 milion e 348 mijë e 524 euro e 18 cent, këtu nga fondet burimore, grandit qeveritar, të hyrat vetanake dhe donacionet, ndërsa egzekutimi i buxhetit ka qenë 14 milion e 93 mijë e 852 euro e 45 cent apo në përqindje 98.23% të hyrat vetanake të inkasuara. Në periudhën Janar-Dhjetor 2022 kanë qenë gjithsej 1 milion e 183 mijë e 367 euro e 92 cent apo mbi planifikimn vjetor të cilin e kemi pasë 19.79%, pra 119.79%, ndërsa të hyrat janë më të larta për 29 mijë e 496 euro e 94 cent. Të aprovuara për vitin 2022 kanë qenë 14 milion e 349 mijë e 507 euro e 8 cent, të alokuara, të cilat i kemi aloku për nevojat e organizatës 14 milion e 348 mijë e 524 euro 18 cent, të paalokuara kanë mbeturë vetëm 982 euro e 90 cent, të shpenzuara kan qenë 14 milion 93 mijë e 852 euro e 45 cent. Te kategoria paga dhe shtesa kemi 7 milion e 938 mijë e 161 euro e 95 cent apo 99.87%; tek mallrat dhe shërbimet kemi 2 milion 231 mi e 21 euro e 83 cent apo 98.32%; Tek komunal kemi 271 mijë e 624 euro e 84 centë apo 84.88%; tek subvencionet kemi 458 mijë e 713 euro e 45 centë apo 80.72%, ndërsa tek kategoria e investimeve kapitale kemi 3 milion e 194 mijë e 330 euro e 38 cent apo 98.52%; në total shpenzimi apo egzekutimi i buxhetit ka qenë 98.23%; diferenca alukim shpenzim ka qenë 254 mijë e 671 euro e 73 centë diferenca në mesë aprovimit dhe shpenzimeve ka qenë 255 mijë e 654 euro e 63 cent, obligimet të cilat na baretn në këtë vitë janë 351 mijë e 880 euro e 24 cent, ndërsa të hyrat që do të barten në vitin 2023 janë 351 mijë euro e 521 euro e 26 cent, diferenca është në negativ për 358 euro e 98 cent. Më tej i kemi të pasqyruara shpenzimet të pergjithshme në pasqyrën e egzekutimit të gjitha linjave buxhetore, gjithashtu i keni për të gjitha programet të cilat i kemi si komunë për vërtetësinë e këtyre pasqyrave. Drejtoria e Financave e merr përgjegjësinë, ndërsa për shpenzimet konkrete që kanë ndodhë, secili program buxhetor i dinë më saktë edhe ne i kemi të gjitha kalojnë te ne, por nëse doni ndonjë informacion, varësisht prej programit. Ju mund të bëni pyetje. Faleminderit!

**z.Ali Bajrami:** Faleminderit kryesues! Nuk do ta zgjas shumë. Elaburoj drejtori pasqyrat financiare Janar-Dhjetor 2022 me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale mbi Ligjin e Financave Publike dhe Ligjin e të Hyrave Komunale i kem pasqyrat të buxhetit që e kemi votu dhe në bazë të pasqyrave që na pasqyrojë është një prej viteve që e kemi shpenzimin më të mirë në përqindje të buxhetit që e kemi votu nëse hyjmë edhe i kqyrem te të hyrat vetanake kemi rritje për 19.76% në vlerë që është një e hyrë që direkt kthehet edhe hynë në shërbim të komunës dhe qytetarëve të komunës, po hy jo në mënyrë specifike, por në mënyrë të përgjithshme prej Zyrës së Kryetarit edhe 10 drejtorit që janë nën menaxhimin e kryetarit, përjashtoj dy drejtori më duket që ke 85% tjerat, kanë mbi 95,98,99% me një mënyrë është bërë punë e mirë që është shpenzu paraaja aty ku ka qenë e planifikume dhe e dedikume krejtë ajo që e rekapitulonë këtu është te projektet e investimeve kapitale 3 milion e 112 mijë euro ose në përqindje është 98.52% që është një menaxhim edhe një shpenzim i bugjetit pikerishtë ashtu qysh e kemi parapa diferenca e përmendi drejtori

351 mijë që nuk janë pagu por janë mjete që barten diku është saldo minus 352 euro faleminderit për vëmendjen për mirëkuptim

**z.Taulant Haxhiu:** Unë gjithmonë po lidhem te qëto, se çdo vit që po i marrim pasqyrat financiare po i kem këto shërbime kontraktuese tjera. Ti i ke pas 24 mijë e 934 të kodit 13460. Unë nuk po mundem me ditë çka nënkuptojnë shërbimet kontraktuese tjera te drejtoria jote. Kemi edhe te Drejtoria e Shëndetësisë, kodit 13430, janë 343 mijë e 930 euro te shërbimet shëndetësore. Tashti nuk po e di çfarë shërbime shëndetësore, a i kemi ble në këtë vlerë. Unë po du me ditë si këshilltar komunal. Te kjo Drejtoria e Shërbimeve Publike, po e shof shërbime telefonike, telefoni fikse 5447 euro, kurse kemi shërbime telefonike mobile 14524. Unë nuk e di ku përdoret telefoni në vlerë 5447, kodit është 13250. Shërbimet kontraktuese, edhe ky i ka 70 mijë e 443 euro; shërbime tjera, kodit 13466, e kam për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pajisje tjera ka 153 mijë, kodit 13509. Unë këtu vetëm po i shënoj si kode shërbime kontraktuese dhe nuk po sqarohesh çka janë ato. Çdo drejtori i ka shërbimet kontraktuese, ne duhet me ditë çka nënkuptojnë shërbimet kontraktuese, e kam fjalën për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ndoshta edhe njëhere ti përsëriti, e kam edhe për Drejtorinë e Shëndetësisë.

**z.Musli Neziri:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për drejtorin e financave! Në këtë rast elaburoj pjesën e financave. Drejtor, deshta me u nderlidhë të pjesa e investimeve kapitale, te pjesa “rregullimi i fushave sportive”. Këtu vlerën e kemi 409 mijë e 999 euro e 93 cent. Gjatë diskutimit që kemi pas gjatë tërë vitit për kryerjen e punëve, prej nënkryetarit të komunës është thanë që, ne nuk paguajmë diçka që nuk është kry puna ose paguajmë në fund kur e kryen punën. Kjo shuma që është këtu mbi 400 mijë euro rregullimi i fushave, po du me nderlidhë: a është kjo? Po shihet që është pagu, po a janë kryer punët për çka është pagu, sepse po du me nderlidhë në kuadër të kësaj edhe fushën në fshatin Ballancë, fushën sportive e cila ke në atë video prezantimin e kryetarit, dhe aty fusha si imazh ka dalë e mirë dhe është punu, pjesa dërmuese është punu, por punimet nuk janë kry, prandaj këtu nuk e di. A je i informuar drejtor, a është kry krejt faza, pagesa e asaj fushe? Sepse nuk është bërë ende ndriçimi dhe ende rrethojat nuk janë përfunduar në kuadër të saj. Nëse ajo fusha është projekti, qëkjo shuma, atëhere po du me ditë a është kry a jo, se puna reale nuk është kry, prandaj pagesa a është kry.

**z.Besnik Imeri, drejtori:** Tek pagesat, egzekutimi i pagesave, Drejtoria e Financave bazohet në situacionet, raportet mbi situacionet e përfunduara të cilat vijnë nga Zyra e Projektive, të cilat janë menaxher të kontratave specifike. Ne bazohemi aty dhe në bazë të raportit të vërtetuar prej tyre në bazë të gjendjes faktike që bëjnë ata në teren ne e ekzekutojmë pagesën në vlerën të cilën na vie për seancën e ardhshme ose kur të kalojsh ka drejtoria mundemi me i thirrë edhe inxhinierat edhe menaxherin e kontratës për punën.

**z.Musli Neziri:** Këtu dashta me të pyet drejtorë, se a është e mundur në seancën e ardhshme me u ditë konkretisht a është krye pagesa për atë, dhe nëse është kry edhe puna me u kry: a mundet me qenë kjo një kërkesë për seancën e ardhshme, që me u deshmu saktë si drejtor i financave? Sepse një farë forme je përgjegjës ti i digasterit.

**z.Besnik Imeri, drejtori:** Është absurde me u kry një pagesë për një punë që nuk është kry, nuk guxon, se ajo është vepër penale. Mirëpo unë po e marrë përgjegjësinë me pru prej menaxherit kontratës me marrë ,cilat fusha janë kry, deri ku kanë përfunduar. Dhe pagesat veç i dimë, i kemi në fund, të gjithë asamblistat i kanë në e-mail kodet.

**z.Basri Aliu, drejtori:** Taulant, fjalën ma jep kryesuesi jo ti, kështu që të kishë kujdes për këtë punë. Taulanti pyeti për kodin 13250, shpenzimet telefonike fikse komunale. Të gjitha telefonat çka janë nëpër drejtori e bëjnë pagesën shërbimet publike, gjithashtu hynë këtu edhe internetet që janë nëpër zyre, gjithçka çka lidhet me posten është këtu, ndërsa kodit 13460 shërbimet kontraktues tjera. Tash janë të gjithë punëtorët me shërbime te veçanta, me kontrata. Në kuadër të kësaj hynë edhe shërbimet tjera, dezinfektimi i hapësirave publike, hartimi i planit komunal për energji, trajtimiti i qeneve endacak, shërbimet me Karitasin për zyret e investimeve. Domethanë në këtë shumë kanë hy të gjitha këto shërbime dhe ke 13509 pajisje tjera, janë të gjitha kontratat për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe dekorimit të qytetit

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kjo pikë është informatë, nuk votohet, kalojmë në piket tjetër.

Si pikë e katërt e rendit të ditës kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kemi parapa sikur çdo vit një orar të mbajteve të takimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit Komunal të Vitisë, dhe në pjesën e fundit parashihet seanca soleme: 17 Shkurti, 5 Maji, 14 Qershori, që janë të parapamë në Statutin e Komunës së Vitisë. Ky është një orar i cili mund të ndryshoj pak, mirëpo kryesisht duhet t'i përmbahemi këtij orari gjatë takimeve në nivelin e vendit. Gushtin

e kemi parapa si pushim, kurse seancat e jashtëzakonshme nuk parashihen. Nëse ka i mbajmë, nëse nuk ka, atëher jo. A ka dikush për diskutim?

**z.Musli Neziri:** Faleminderit kryesues! Për 28 Nëntor nuk është e parapamë, nuk e di, ne kemi mbajtur seancë në 2022.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne jemi të obligim në bazë të Statutit dhe në Statut nuk është pjesë e festave zyrtare, por është pjesë që është me vendim të Qeverisë për mbajtjen e festat zyrtare. Janë këto që parashihen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

**z.Ali Bajrami:** Kryesues, ky është një obligim ligjor që duhet ta kryejmë si Kuvend, është përcaktimi i orarit të mbajtjes së seancave, prandaj ne si grup parlamentar do ta mbështesim dhe do të votojmë pro këtij propozimi për orarin e mbajteve të seancave edhe të komitetit edhe të Kuvnedit Komunal. Falemindert!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kush është për që të miratohet kjo pikë? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Pra, nga të gjithë anëtarët prezent miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës është:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planeve të punës së komiteteve: Komitetit për Shërbime Publike; Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore; Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit; Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport; të gjitha planet për vitin 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Të gjitha komitetet që nuk janë obligative e kan paraqitë planin e punës për vitin 2023, dhe ato plane të punës e kërkojnë një miratim formal edhe në Kuvend, që ata kanë planë të vetin që i përmbahen gjatë vitit kalendarikë. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Kundër nuk ka, absetnim nuk ka, pra nga të gjithë miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës është:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E dini që Këshilli për Siguri në Bashkësi është i themeluar nga Kuvendi Komunal në bazë të ligjit dhe ato zakonisht i binë edhe raportet, informatën në Kuvend dhe ata kanë paraqitë planin e punës të cilën e parashofin gjatë këtij viti kalendarik. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: kush është me ngritje dorës ta votojmë planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi? Pra, me të gjitha votata miratohet, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet. Faleminderit shumë, shiheim në seancën e radhës. Punë të mbarë!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:40 min.

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

